

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë**

Departamenti i të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit

Seksioni për monitorim të sistemit juridik

SHQYRTIM I SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE NË KOSOVË

Mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale

Administrimi i drejtësisë në gjykatat për kundërvajtje

Të miturit në procedurën penale

(2006)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	4
SFOND	6
KAPITULLI 1.....	8
MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE	8
I. KORNIZA LIGJORE	8
A. <i>Dispozitat e KPPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve</i>	<i>9</i>
B. <i>Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe zhvendosja e dëshmitarëve</i>	<i>10</i>
II. PROBLEMET LIDHUR ME MBROJTJEN E DËSHMITARËVE NË KOSOVË.....	11
A. <i>Problemet me Njësitin për mbrojtjen e dëshmitarëve (NJMD) dhe zhvendosje të dëshmitarëve</i>	<i>11</i>
B. <i>Problemet në aplikimin e dispozitave të KPPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve</i>	<i>12</i>
III. INCIDENTET E FRIKËSIMIT.....	13
A. <i>Frikësimet në rastet e të pandehurve të profilin të lartë</i>	<i>13</i>
B. <i>Kërcënimet ndaj viktimave të veprave penale kundër integritetit seksual.....</i>	<i>15</i>
IV. REKOMANDIMET.....	17
KAPITULLI 2.....	19
ADMINISTRIMI I DREJTËSISË NË GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE.....	19
I. KORNIZA LIGJORE	19
A. <i>Ligji për Gjykatat e Kundërvajtjes në Kosovë.....</i>	<i>19</i>
B. <i>Klasifikimi i kundërvajtjeve si vepra penale në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ.....</i>	<i>20</i>
i) <i>Klasifikimi i veprës</i>	<i>20</i>
ii) <i>Natyra e veprës</i>	<i>20</i>
iii) <i>Natyra dhe pesha e dënimit</i>	<i>21</i>
II. SHKELJET E VËZHGUARA TË LIGJIT VENDOR DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.....	22
A. <i>Mungesa ose definicioni i gabueshëm i akuzave në kërkesën për fillimin e procedurës</i>	<i>22</i>
B. <i>Mungesa e vendimeve të arsyetuara</i>	<i>24</i>
C. <i>Mungesa e dënimeve individuale</i>	<i>26</i>
D. <i>Shkelja e parimit ne bis in idem në lidhje me aktgjykimet e mëparshme të lëshuara nga Gjykatat për Kundërvajtje.....</i>	<i>27</i>
III. REKOMANDIMET	28
KAPITULLI 3.....	30
TË MITURIT NË PROCEDURËN PENALE.....	30
I. KORNIZA LIGJORE	30
II. SHKELJET E VËZHGUARA TË LIGJIT VENDOR DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË SË DREJTAVE TË NJERIUT	31
A. <i>Gjykata jo e themeluar në pajtim me ligj.....</i>	<i>31</i>
B. <i>Vonesat në procedurat penale kundër të miturve.....</i>	<i>33</i>
C. <i>Kohëzgjatja e paraburgimit.....</i>	<i>35</i>
D. <i>Procedurat e kundërligjshme ndaj të miturve në Gjykatat për Kundërvajtje.....</i>	<i>37</i>
III. REKOMANDIMET.....	38

FJALORTH

DD	Departamenti i drejtësisë
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
KEDNJ	K onventa Evropiane për Mbrojtjen e të D rejtave dhe Lirive Themelore të N jeriut
GjEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
LPM	Ligji penal për të mitur
KGJK	Këshilli gjyqësor i Kosovës
IGJK	Instituti gjyqësor i Kosovës
SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
GjK	Gjykata për Kundërvajtje
LK	Ligji për Kundërvajtje
LQRP	Ligji mbi Qetësinë dhe Rendin Publik
SMSJ	Seksioni për monitorim të sistemit juridik
OMiK(Orig)	Misioni i OSBE-së në Kosovë
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
KPPK	Kodi i përkohshëm penal i Kosovës
KPPPK	Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
KB	Kombet e Bashkuara
UNMIK(Orig)	Misioni i administratës të përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
NJMD	Njësi për mbrojtjen e dëshmitarëve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në pajtim me mandatin që e ka, Seksioni për monitorim të sistemit juridik (SMSJ), si pjesë e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – Misioni në Kosovë (OSBE), monitoron sistemin e drejtësisë, e vlerëson pajtueshmërinë e tij me të drejtat e njeriut të parapara me ligjin vendor dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe rekomandon zgjidhje të qëndrueshme për të siguruar se këto standarde janë duke u siguruar.

Gjatë ushtrimit të mandatit të vet SMSJ i përmbahet një procesi tre hapësh: monitoron gjykimet në procedurën për kundërvajtje, ato në nivelin e gjykatave komunale dhe të qarkut; raporton për fushat e shqetësimit dhe bën rekomandime specifike për adresimin e shqetësimeve; dhe e përcjellë zbatimin e rekomandimeve të paraqitura në raporte, përmes takimeve me homologët relevantë vendor dhe ndërkombëtarë.

Ky shqyrtim është shqyrtimi i tetë publik mbi sistemin e drejtësisë penale të Kosovës, që është përgatitur nga Seksioni për monitorim të sistemit juridik. Në këtë shqyrtim, SMSJ fokusohet në çështjet e të drejtave të njeriut që dalin nga tri fushat e sistemit të drejtësisë penale: 1) mbrojtja e dëshmitarëve; 2) gjykatat për kundërvajtje, dhe 3) ligji për të miturit.

Kreu i parë i shqyrtimit analizon gjendjen aktuale të sistemit të mbrojtjes së dëshmitarëve në Kosovë dhe nënvizon incidentet e frikësimit të dëshmitarëve që i ka monitoruar OSBE-ja. OSBE ka identifikuar boshllëqe në legjislacionin me të cilin rregullohet mbrojtja e dëshmitarëve, veçanërisht në atë që ka të bëjë me programin e zhvendosjes së dëshmitarëve për shumicën e rasteve penale më të rënda. Krahas kësaj, autoritetet nuk i zbatojnë dispozitat ekzistuese nga Kodi i përkohshëm i procedurës penale të Kosovës, lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve. Bazuar në rastet e përcjella të frikësimit të dëshmitarëve, OSBE ndanë shqetësimin se dështimi i autoriteteve që t'ju ofrojnë mbrojtje efektive dëshmitarëve, e parandalon ndjekjen penale efektive të kriminelëve të supozuar, pengon themelimin e sundimit të ligjit në Kosovë, dhe e dëmton besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. OSBE-ja rekomandon që autoritetet t'i japin prioritet zhvillimit dhe zbatimit të mëtutjeshëm të sistemit të Kosovës për mbrojtjen e dëshmitarëve. Krahas kësaj, OSBE nxitë autoritetet që ta ngritin vetëdijen e publikut lidhur me detyrën morale dhe ligjore të banorëve për të bashkëpunuar si dëshmitarë në rastet penale.

Kreu i dytë i shqyrtimit fokusohet në pajtueshmërinë e gjykatave të kundërvajtjes me ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në të kaluarën, SMSJ kryesisht ka monitoruar gjykatat e qarkut dhe ato komunale. OSBE ka monitoruar rastet nën shqyrtim të gjykatave për kundërvajtje vetëm mbi bazën *ad hoc*. Në këtë kapitull, OSBE nënvizon problemet procedurale nëpër gjykatat për kundërvajtje, siç janë, arsyetimi i dobët dhe jo i plotë i vendimeve, thirrja e gabuar në nenet përkatëse të Ligjit për kundërvajtje, dhe caktimi i dënimeve “kolektive” gjë që e shmang përcaktimin individual të shkallës së përgjegjësisë. Në fund, OSBE ka analizuar problemin që, duke pasur parasysh se shumica e veprave nën kompetencën e gjykatave për kundërvajtje, nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) do të trajtoheshin si vepra penale, këtu mungojnë masa mbrojtëse procedurale dhe gjykatat e kanë shkelur parimin *ne bis in idem* (ose ndalimin e rrezikut të dyfishtë).

Përfundimisht, në kapitullin e tretë të shqyrtimit, OSBE fokusohet në shkeljet e ligjit vendor (Ligjin më të ri penal për të mitur) dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që lidhen me të miturit në sistemin e drejtësisë penale. SMSJ ka përcjellë raste të shkeljeve procedurale siç janë, përbërja jo e rregullt e trupit gjykues, zvarritjet e procedurës penale me të mitur, paraburgime të gjata dhe jo të ligjshme për të pandehurit e mitur dhe procedura të paligjshme të kundërvajtjes kundër të miturve më të rinj se katërmbëdhjetë vjeç.

Pas identifikimit të çështjeve problematike, OSBE nxjerrë një numër rekomandimesh nëpër secilin kapitull, dhe të cilat synojnë korrigjimin e mangësive. Autoritetet relevante inkurajohen t'i zbatojnë këto rekomandime dhe t'i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për korrigjimin e mangësive të nënvizuara.

Sfond

Ky shqyrtim është përgatitur nga Seksioni për monitorimin e sistemit juridik, që është pjesë e Departamentit për të drejtat e njeriut dhe sundim të ligjit (departamenti) në kuadër të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (Misioni i OSBE-së në Kosovë). OSBE funksionon nën ombrellën e Administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), në cilësinë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve.

Mandati i SMSJ-së

Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KB-ve të themeloj një prezencë civile ndërkombëtare në Kosovë që do të ofronte administrim të përkohshëm. Një nga përgjegjësitë kryesore të prezencës ndërkombëtare është *“mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut”*¹.

Në bazë të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve dhënë para Këshillit të Sigurimit të KB-ve me 12 Qershor 1999, roli i ndërtimit të institucioneve përbrenda UNMIK-ut ishte caktuar për OSBE-në. Njëra nga detyrat e Shtyllës për Ndërtim-Institucionesh ishte caktuar të jetë monitorimi i të drejtave të njeriut. Raporti shprehimisht udhëzoi UNMIK-un të zhvilloj mekanizma të koordinuara të lehtësoj monitorimin e të drejtave të njeriut dhe zhvillimin e drejtë të sistemit juridik².

Një letër marrëveshjeje e datës 19 Korrik 1999, e lidhur në mes Nënsekretarit Gjeneral të KB-ve për Operacione Paqeruajtëse dhe Përfaqësuesit të Kreut të Zyrës së OSBE-së, thotë se OSBE-ja duhet të zhvilloj mekanizma që të siguroj se gjykatat, gjyqet administrative si dhe strukturat tjera gjyqësore funksionojnë në pajtim me standardet ndërkombëtare për drejtësinë penale dhe të drejtat e njeriut.³ Përbrenda OSBE-së, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit ka përgjegjësinë të monitoroj dhe raportoj mbi sistemin juridik nga perspektiva e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Brenda OSBE-së, Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të Ligjit, SMSJ ka për detyrë të kryej rolin e monitorimit të rasteve në sistemin juridik, të vlerësoj përputhjen e tyre me standardet ndërkombëtare dhe të raportoj për çështjet shqetësuese.

¹ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, 12 Qershor 1999, par.11/j.

² Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve dhënë para Këshillit të Sigurimit të KB-ve *mbi Administrimin e Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, S/1999/779, 12 Qershor 1999, para.87.

³ Qarkorja e Drejtësisë 2001/15, Qasja e Monitorëve të OSBE-së në Procedurat dhe Dokumentet Gjyqësore, 6 Qershor 2001 ri-konfirmoi se monitorët e gjykimeve të SMSJ-së kanë qasje në të gjitha procedurat penale gjyqësore si dhe dokumente, me disa përjashtime. Kjo ishte ndryshuara me Qarkoren e Drejtësisë 2004/6, 30 Shtator 2004 e cila siguroi se SMSJ ka gjithashtu qasje në procedurat gjyqësore civile dhe administrative si dhe në dokumentet gjyqësore bazuar në një marrëveshje ndërmjet Policisë, Shtyllës së Drejtësisë së UNMIK-ut dhe OSBE-së. Kjo qarkore kishte për qëllim ngris vetëdijen e gjyqësorit në lidhje me mandatin e OSBE-së, dhe të siguroj që monitorët gjyqësor kanë mbulesë të plotë në procedurat penale, civile dhe administrative.

Qëllimi i Shqyrtimit

Ky shqyrtim është i fokusuar në tema dhe kryesisht koncentrohet në tri fusha të cilat kanë ngjallur shqetësime të monitorët e procedurave penale të OSBE-së. OSBE ka vendosur të raportoj për çështjet që përfaqësojnë shqetësime të përsëritura dhe të pazgjedhura siç janë ato që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale si dhe në ato fusha të cilat nuk ishin monitoruar për së afërmi më parë siç janë procedurat para gjykatave për kundërvajtje ku përfshihen të miturit, qoftë si të pandehur apo si palë të dëmtuara në raste të caktuara penale.

Kapitulli 1

MBROJTJA E DËSHMITARËVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË PENALE

Të mbrohen dëshmitarët⁴ e veprave penale nga kërcënimet ose frikësimet ka qenë, është dhe mbetet një nga sfidat më të mëdha për autoritetet gjyqësore të Kosovës. Përkundër ligjit vendor me procedurën përkatëse në dispozicion për mbrojtjen e dëshmitarëve (siç është, deklarata anonime dhe nga distanca, dëgjimi pa prezencën e publikut, ndarja fizike e të pandehurit nga dëshmitari), shumë pak dëshmitarë janë të gatshëm ta japin dëshminë e tyre në gjyq. Rregullisht raportohen incidente të frikësimi të dëshmitarëve.

Edhe pse OSBE më herët ka raportuar lidhur me problemet përkitazi me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale në Kosovë,⁵ për shkak të dështimit për zgjidhjen e këtyre problemeve paraqitet nevoja për rishqyrtimin e tyre. Për më tepër, OSBE së fundit ka monitoruar raste kur autoritetet gjyqësore dhe autoritetet tjera relevante (p.sh., policia) nuk i janë përgjigjur në mënyrë adekuate frikësimit të dëshmitarëve. Gjithashtu, policia nuk i ka dhënë në mënyrë të duhur deklaratat në procedurën penale ndaj individëve të dyshuar se kanë kërcënuar dëshmitarët.

Kjo kaptinë përshkruan strukturën ligjore ndërkombëtare dhe vendore që ka të bëjë me mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë. Nënvizon zbrazëtira dhe probleme rreth implementimit të legjislacionit aktual mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe i referohet shembujve të llojeve më të zakonshme të frikësimeve ndaj dëshmitarëve.

Në përgjithësi, Kosovës i nevojitet një ligj i kompletuar për mbrojtjen e dëshmitarëve me të cilin mundësohet ndërrimi i identitetit dhe rivendosjes jashtë territorit të Kosovës, i dëshmitarëve okularë, viktimave dhe dëshmitarëve bashkëpunëtor të rasteve penale më të rënda dhe komplekse, siç janë ato që kanë të bëjnë me krimin e organizuar, trafikimin dhe krimet e luftës. Më tutje, gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'i zbatojnë metodat e tanishme të mbrojtjes së dëshmitarëve të parapara me Kodin e përkohshëm të procedurës penale të Kosovës⁶ (KPPPK). Së fundi, autoritetet vendore dhe ndërkombëtare duhet ta ngrisin vetëdijen e banorëve të Kosovës për detyrën morale dhe ligjore mbi dhënien e dëshmisë gjyqësore dhe për sjelljen e kriminelëve para drejtësisë.

I. KORNIZA LIGJORE

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), jeta, liria, ose siguria e dëshmitarëve nuk duhet të “vihet në rrezik të paarsyeshëm”⁷.

⁴ Termi “dëshmitarë” i referohet dëshmitarëve okular dhe viktimave të krimit. Të dy llojet e “dëshmitarëve” mund të japin dëshmi kyçe në gjykim.

⁵ Shih, p.sh., Misioni i OSBE-së në Kosovë, *Përgjigja e sistemit të drejtësisë ndaj trazirave të marsit 2004*, 2 dhjetor 2005, f. 8-21; *Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale (prill 2003 - tetor 2004) krimi, burgimi dhe dënimi*, 14 dhjetor 2004, f. 74-77; *Shqyrtimi i sistemit të drejtësisë penale (mars 2002 – prill 2003) mbrojtja e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale*, 20 maj 2003.

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/26 për Kodin e përkohshëm të procedurës penale në Kosovë, 6 korrik 2003.

⁷ “Është e vërtetë se neni 6 [...] nuk kërkon në mënyrë të shprehur interesin e dëshmitarëve në përgjithësi, dhe të viktimave të thirren për të dëshmuar në veçanti, që këto të merren parasysht. Mirëpo,

Prandaj autoritetet publike e kanë për detyrë t'i mbrojnë dëshmitarët dhe të afërmit e tyre të ngushtë, ndaj ndërhyrjeve, kërcënimeve dhe rrezikut, dhe në kohën para, gjatë dhe pas gjykimit⁸. Mbrojtja efektive e dëshmitarëve është kyçe për sistemin ligjor që të funksionojë ashtu si duhet⁹.

Për inkurajimin e dhënies së dëshmimeve dhe përkrahjen e ndjekjes penale sa më të suksesshme, Kosova e ka nxjerrë legjislacionin i cili ka për qëllim mbrojtjen e dëshmitarëve.

A. *Dispozitat e KPPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve*

The KPPPK lejon fshehjen e identitetit të dëshmitarëve, gjykimin jopublik, largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatorja gjatë dhënies së dëshmisë nga ana e dëshmitarit, dëshmia nga distanca (p.sh., përmes metodës së video-konferencës ose transmetimin televiziv të qarkut të mbyllur), ose videoregjistrimin para seancës së dëgjimit me praninë e mbrojtësit.¹⁰

Dy raste kryesore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kanë konstatuar se përdorimi i dëshmisë anonime nga faza e hetimeve, për aq sa i pandehuri ose mbrojtësi i tij e kanë mundësinë e marrjes në pyetje të dëshmitarit, nuk paraqet domosdoshmërisht shkelje të të drejtës së pandehurit të paraparë në nenin 6 përkitazi me gjykimin e drejtë. Mirëpo, vendimi mbi dënimin nuk duhet asnjëherë të bazohet vetëm ose “deri në shkallë vendimtare” bazuar në deklaratat anonime.¹¹ KPPPK i përmbahet këtij udhëzimi duke paraparë se “gjykata nuk e shpall të akuzuarin fajtor

jeta e tyre, liria ose siguria e personit mund të rrezikohet, ashtu si mundën edhe interesat nga neni 8 i Konventës [...]. Këto interesa të dëshmitarëve dhe viktimave në parim mbrohen me dispozita tjera të Konventës, të cilat nënkuptojnë që shtetet palë duhet ta organizojnë procedurën e tyre penale në atë mënyrë që këto interesat mos të cenohen në mënyrë të pajustificueshme. Karshi kësaj, gjithashtu parimet e gjykimit të drejtë kërkojnë që në raste të caktuara të balancohen interesat e mbrojtjes të atyre dëshmitarëve ose viktimave të thirrura për të dëshmuar.” Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, *Van Mechelen dhe të tjerët kundër Holandës*, 21363/93, 21364/93, 21427/93, 23 prill 1997, para. 53; *Doorson kundër Holandës*, 20524/92, 26 mars 1996, para. 70; *P.S. kundër Gjermanisë*, 33900/96, 20 dhjetor 2001, para. 22. Është citati nga të gjitha këto raste?

⁸ “Duke respektuar të drejtat e mbrojtjes, duhet të organizohet mbrojtja e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve të drejtësisë dhe njerëzve të afërt me ta, sa herë që është e nevojshme, para, gjatë dhe pas gjykimit”, Komiteti i ministrave të shteteve palë të Këshillit të Evropës, rekomandimi (2005)9 *mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*, 20 prill 2005, neni II(2). Për një pasqyrë të çështjeve të përgjithshme që kanë të bëjnë me mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë penale, ju lutemi lexoni Zyra e Kombeve të Bashkuara për drogat dhe krimin, grupin punues joformal për *mbrojtjen e dëshmitarëve në sistemin e drejtësisë*, Vjenë 22-24 shtator 2005.

⁹ “[...] është e papranueshme për sistemin e drejtësisë penale të dështojë ta sjellë të pandehurin në gjykim dhe të dështojë ta merr aktgjykim për shkak se dëshmitarët kanë qenë në mënyrë efektive të dekurajuar nda dëshmia e lirë dhe e vërtetë.” Komiteti i ministrave të shteteve palë të Këshillit të Evropës, rekomandimi (2005)9 *mbi mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë*, 20 prill 2005, preambula.

¹⁰ Nenet 168 – 174, të KPPPK-së. Para hyrjes në fuqi të KPPPK-së, ishte Rregullorja nr. 2001/20 *për mbrojtjen e palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve në procedurë penale*, e 20 shtatorit 2001 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/1 e 24 janarit 2002) dhe Urdhëresa administrative nr. 2002/25 të 13 nëntorit 2002, të cilat kanë paraparë masat për fshehjen e identitetit të dëshmitarëve gjatë dhënies së dëshmisë.

¹¹ *Shih Doorson kundër Holandës, si më lart në fusnotën 4*, para. 68-71 dhe *Kostovski kundër Holandës* 11454/85, 20 nëntor 1989, para. 44.

vetëm ose duke i dhënë rëndësi vendimtare dëshmisë së dhënë nga një dëshmitar, identiteti i të cilit është i panjohur për mbrojtësin dhe të akuzuarin”¹².

Përdorimi i dëshmimeve anonime (veçanërisht ato pa zhvendosje) mund të jenë problematike. Para së gjithash, i pandehuri shpesh “qëllon” identitetin e vërtetë të dëshmitarit anonim bazuar në natyrën dhe specifikat e dëshmisë. Krahas kësaj, ashtu si është shpjeguar më lart, vendimi mbi dënimin i cili bazohet “vetëm” ose “në masë vendimtare” në dëshminë anonime, mund të ngritë shqetësimet që ndërlidhen me përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë.¹³

B. Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve dhe zhvendosja e dëshmitarëve

“Programi i mbrojtjes së dëshmitarëve” ofron mbrojtjen fizike për dëshmitarët para, gjatë dhe pas gjykimit, dhe kjo bëhet përmes njësitit të specializuar të policisë, të njohur si Njësi i UNMIK-ut për mbrojtjen e dëshmitarëve (NJMD). Qarkorja e Drejtësisë Nr. 2003/5 mbi Programin e Mbrojtjes së Dëshmitarëve shkurtimisht përshkruan procedurën për hyrjen në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve. Ose prokurori ose gjyqtari i rekomandon NJMD-së hyrjen në program të një dëshmitari, dhe pastaj NJMD e bën analizën e kërcënimit. Dëshmitari gjithashtu vlerësohet nga aspekti fizik dhe psikologjik për të parë nëse mund ta tolerojë stresin e programit. Nëse pranohet, dëshmitari dhe familja e tij e ngushtë transferohen në vend të sigurt gjatë mbajtjes së gjykimit. Pas përfundimit të gjykimit, bëhen përpjekje për zhvendosjen e dëshmitarëve jashtë Kosovës.

Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve ka për synim mbrojtjen e dëshmitarëve për shumicën e rasteve më të rënda penale siç janë, krimi i organizuar,¹⁴ trafikimi me njerëz¹⁵ dhe krimet e luftës.¹⁶ Dispozitat për mbrojtjen e dëshmitarëve të KPPPK-së (sikur dëshmia anonime, veçimi i të pandehurit nga dëshmitari dhe seanca jopublike) duhet të përdoret në shumicën e rasteve kur dëshmitarët mund t’i nënshtrohen frikësimit dhe nuk janë në listën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Duhet përmendur se në Kosovë nuk ka ndonjë ligj ose procedurë të hollësishme për hyrjen e dëshmitarëve në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve, për ndryshimin e identitetit të tyre dhe zhvendosjen e tyre jashtë Kosovës pas kryerjes së gjykimit. “Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve” bazohet në një “qarkore” të shkurtër e cila nuk është e mjaftueshme. Projekt rregullorja për mbrojtjen e dëshmitarëve është shpërndarë për komente, dhe duhet t’i jepet prioriteti më i lartë hyrjes në fuqi dhe zbatimit të këtij ligji.

¹² KPPPK, neni 157(3).

¹³ Komiteti i të drejtave të njeriut ka ngritur shqetësimet nëse përdorimi i dëshmitarëve anonimë është në pajtim me parimet e gjykimit të drejtë ashtu si janë të mishëruara në PNDCP (Shih, Komiteti i të drejtave të njeriut, vërejtjet përfundimtare për Holandën (2001), UN doc. CCPR/CO/72/NET, para. 12; shih gjithashtu Vërejtjet përfundimtare për Kolumbinë (1997), UN doc. CCPR/C/79/Add. 75, paras. 21 dhe 40).

¹⁴ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, *për Kodin e përkohshëm penal të Kosovës* (KPPK), 6 korrik 2003, nenet 274 dhe 310.

¹⁵ KPPK, neni 139.

¹⁶ KPPK, kreu XIV: veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare.

II. PROBLEMET LIDHUR ME MBROJTJEN E DËSHMITARËVE NË KOSOVË

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe nxitja e tyre për bashkëpunim në Kosovë është e vështirë për shumë arsye. Së pari, për shkak të territorit të vogël të Kosovës dhe lidhjeve të afërta familjare, një numër relativisht i madh i dëshmitarëve ka gjasa të “njihen” nga kryerësit e supozuar dhe/ose nga publiku, prandaj edhe me gjasa t’i nënshtrohen frikësimit, e gjithashtu kanë nevojë për mbrojtje. E dyta, në rastet e profilit të lartë, nuk është praktike të zhvendosen dëshmitarët përbrenda për shkak se Kosova është një shoqëri me lidhje të fuqishme familjare dhe në një rajon relativisht të vogël gjeografik. E treta, historia e diskriminimit dhe shtypjes nga autoritetet që i është bërë banorëve të Kosovës, i ka bërë qytetarët të mos i besojnë qeverisë dhe gjyqësisë, dhe hezitojnë të shërbejnë si dëshmitarë të rasteve penale. Shumica e qytetarëve nuk besojnë se kanë detyrë morale e as ligjore për të shërbyer si dëshmitar në rastet penale.¹⁷

A. *Problemet me Njësitin për mbrojtjen e dëshmitarëve (NJMD) dhe zhvendosjen e dëshmitarëve*

Për shkak të territorit të vogël të Kosovës, është fare e pamundur të mbrohen dëshmitarët e rasteve penale të profilit të lartë, duke ua ndërruar identitetin dhe vendbanimin dëshmitarëve brenda Kosovës. Vendosja jashtë Kosovës është e vetmja mënyrë e sigurimit të dëshmitarëve të rrezikuar për hakmarrje nga të pandehurit ose kriminelët bashkëpunëtorë të tyre.

NJMD është duke bërë përpjekje t’i zhvendosë dëshmitarët përmes asistencës së shefave të zyrave ndërlidhëse të shteteve të huaja në Kosovë.¹⁸ Njëri problem është mungesa e mjeteve financiare për transferimin dhe përkrahjen e dëshmitarëve të zhvendosur. Krahas kësaj, disa shtete janë të gatshme t’i pranojnë dëshmitarët e zhvendosur nga Kosova. Në rastet e suksesshme, dëshmitarët e zhvendosur janë pranuar mbi bazën e një gjysmë azili. E treta, sikur që u përmend më lart, Kosova nuk ka ndonjë ligj gjithëpërfshirës ose procedurë me të cilën rregullohet futja në listën e programit për mbrojtje të dëshmitarëve dhe përgjegjësitë e dëshmitarëve të mbrojtur. Në fund, NJMD ka mungesë të përvojës policore të specializuar në mbrojtjen e dëshmitarëve.

Sipas intervistave të tetorit 2006 të zhvilluara nga OSBE-ja me shefin e NJMD-së, shumë prej problemeve administrative me të cilat ballafaqohen NJMD-të paraqiten për shkak se buxheti i njësisë nuk është i ndarë nga institucionet ndërkombëtare dhe vendore të Kosovës. Shumica e fondeve sfidohen nga buxheti i Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK) ose subjektet tjera, duke shkaktuar vonesa burokratike dhe duke parandaluar ndarjen efikase të resurseve. Krahas kësaj, nevoja për dorëzimin e faturave të pranimit dhe dokumenteve tjera për arsyetimin e shpenzimeve tek

¹⁷ Neni 158 i KPPPK-së, thotë: “Çdo person i thirrur si dëshmitar detyrohet t’i përgjigjet thirrjes, e kur me këtë Kod nuk është caktuar ndryshe, detyrohet edhe të dëshmojë.” Neni 167 i KPPPK-së parashikon gjobën ose burgimin e dëshmitarit i cili refuzon të paraqitet pa arsyetim ligjor.

¹⁸ Sipas intervistës së zhvilluar nga OSBE me shefin e NJMD-së, ka pasur disa përpjekje të pasuksesshme që të bindet Komisionari i lartë e Kombeve të Bashkuara për refugjatë (UNHCR) dhe Organizata Ndërkombëtare për Migrim (ONM - IOM) që të përfshihen në procesin e zhvendosjes së dëshmitarëve.

institucionet e jashtme, e komprometon besueshmërinë e aktiviteteve të NJMD-së dhe e rrezikon sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur.

Një problem tjetër madhor është mungesa e sistemit të qartë të arkivimit, shkëmbimit, deponimit dhe përfundimisht shkatërrimit të informatave të ndjeshme që kanë të bëjnë me aktivitetet e NJMD-së dhe për dëshmitarët e mbrojtur. Prandaj, informatat konfidenciale mund të rrjedhin me rastin e shpërndarjes së tyre dhe kjo për shkaqe burokratike/të brendshme. Kjo mund ta rrezikojë sigurinë e dëshmitarëve të mbrojtur.

Ka dështime edhe në çështjen e ruajtjes dhe mbrojtjes së duhur të konfidencialitetit me rastin e ndërrimit të identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur. Sipas hulumtimit të OSBE-së,¹⁹ punëtorët e regjistrat civil momentalisht i modifikojnë të dhënat personale të dëshmitarëve nën mbrojtjen e NJMD-së. Kosova nuk ka legjislacion me të cilin rregullohet ky aktivitet i rëndësishëm dhe shërbyesi civil ma mundësi ta lëshoj detajin me rastin e ndërrimit të identitetit të personit.

Pa një program efektiv të mbrojtjes së dëshmitarëve, Kosova nuk mund të shpresojë çrrënjosjen e krimit të organizuar. Përvojat nga Shtetet e Bashkuara dhe Italia tregojnë se mënyra më efikase për luftimin e bandave të krimit të organizuar është kur kriminelët bashkëpunojnë dhe dëshmojnë kundër bashkëpunëtorëve të tyre kriminel. Pa u ofruar dëshmitarëve bashkëpunëtor një përfitim (siç është dënimi më i butë) dhe pa u mbrojtur ata, atëherë dëshmitari nuk do të bashkëpunojë.²⁰

B. Problemet në aplikimin e dispozitave të KPPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve

Në shumicën e rasteve kur dëshmitarët nuk janë në listën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve, gjyqtarët kanë në dispozicion edhe metoda tjera për mbrojtjen e dëshmitarëve. Këto përfshijnë, dëshmitë anonime, ndarja fizike e të pandehurit nga dëshmitari, dëshmia nga distanca, dhe dëgjimet jopublike. Hulumtimi i OSBE-së ka zbuluar se shpeshherë gjykatat nuk i aplikojnë këto masa.²¹ Për shembull, shumica e gjykatave nuk i kanë hyrjet e veçanta për dëshmitarët që do t'ju ndihmonte atyre të jenë të vetëm dhe të mbrojtur nga presioni ose ekspozimi publik. Kjo gjendje nuk është ndihmuar nga sjellja e papërgjegjshme e disa gazetave vendore të cilat e kanë zbuluar identitetin e dëshmitarëve "anonim". Përfundimisht, ka pak ose fare ndjekje penale të individëve të cilët kërcënojnë ose sulmojnë dëshmitarët.

¹⁹Nga intervista e zhvilluar e OSBE-së me shefin e NJMD-së në tetor 2006.

²⁰ Opinioni i Ekipit Këshillues për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Zyrës së SHBA-ve dhe OSBE-së (Tetor 2006)

²¹ Për shembull, në nëntor të vitit 2006, OSBE ka monitoruar gjykimin lidhur me një akuzë për tentim vrasje. Gjatë seancës dëshmitarët ishin ulur afër të pandehurit dhe dëshmia e tyre ishte në kundërshtim me deklaratën e dhënë më herët gjatë hetimeve dhe nuk i mbështesnin deklaratat e mëhershme inkriminuese ndaj të akuzuarit. Dëshmitarët më herët kishin deklaruar se i pandehuri fillimisht kishte shtënë me armë në drejtim të tyre, me ç'rast ishin plagosur disa njerëz. Është e paqartë nëse frikësimi i dëshmitarëve, krahas marrëveshjes, ose ndërhyrjes së familjes/pajtimit, ka rezultuar ose jo në këtë ndryshim të deklarimeve. Vlen të përmendet se as gjyqtari e as prokurori nuk kanë sugjeruar që dëshmitarët të japin dëshmitë e tyre pa praninë e të pandehurit ashtu si e parashikon KPPPK-ja, gjegjësisht neni 170(1) pika 7.

Për përmbledhur, programi i mbrojtjes së dëshmitarëve ka mungesë të mjeteve, është i bazuar në legjislacion të papërfunduar, i mungojnë policë të specializuar për mbrojtjen e dëshmitarëve, dhe ju mungon përkrahja nga vendet të cilat nuk janë të vullnetshme t'i pranojnë dëshmitarët nga Kosova që të zhvendosen aty. Krahas kësaj, gjyqtarët nuk e aplikojnë në mënyrë adekuate procedurën e KPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve. Rrjedhimisht, kërcënimet dhe frikësimet ndaj dëshmitarëve janë të zakonshme në Kosovë dhe ka më pak dënime për kriminelët e supozuar për shkak të mungesës së dëshmive nga dëshmitarët.

III. INCIDENTET E FRIKËSIMIT

A. *Frikësimet në rastet e të pandehurve të profilit të lartë*

OSBE është në njohuri të disa rasteve të sulmeve dhe frikësimeve ndaj dëshmitarëve, sikur dëshmitarëve okular ashtu edhe viktimave. OSBE ka vërejtur shumicën e problemeve të frikësimit të dëshmitarëve në rastet e të pandehurve të profilit të lartë, gjegjësisht pjesëtarëve të ish-UÇK-së²². Mirëpo, kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur frikësime edhe në rastet e profilit më të ultë, për shkak se frikësimi është vështirë të provohet.

Shembujt si në vijim tregojnë se si kërcënimet dhe dhuna ndaj dëshmitarëve (viktimave dhe dëshmitarëve okularë) e pengon ndjekjen penale efektive të njerëzve që supozohet se janë përgjegjës për krime të rënda dhe si e pengon sundimin e ligjit në Kosovë:

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, për veprën penale të supozuar të pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare²³ dhe të detyrimit,²⁴ me 16 janar 2006 prokurori ndërkombëtar ka filluar hetimet ndaj një të pandehuri shqiptar të Kosovës, ish-komandant i UÇK-së. Supozohet se, me 14 nëntor 2005 i pandehuri i ka kërcënuar dy pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës dhe gjyqtarin ekzekutues gjatë dëbimit nga lokali komercial që siç raportohet ka qenë i okupuar ilegalisht që nga qershori i vitit 1999. Gjyqtari ndërkombëtar e ka mbajtur seancën e konfirmimit me 12 shtator 2006 dhe ka konfirmuar aktakuzën dhe të gjitha pikat e saj.

OSBE është në dijeni se pak ditë para seancës së konfirmimit, gjyqtari ekzekutues ka shkuar në zyrën e shefi të gjyqtarëve ndërkombëtarë duke kërkuar që lëndën ta merr gjyqtari ndërkombëtar për konfirmim. Gjyqtari ekzekutues është dukur mjaft i frikësuar dhe ka raportuar se një njeri i panjohur iu ka afruar dhe e ka kërcënuar atë duke i thënë se nuk do të duhej të dëshmonte në gjykim. Rrjedhimisht, gjyqtari ekzekutues ka deklaruar se nuk dëshiron të paraqitet në gjykim ose të merr pjesë në procedurë. Në të vërtetë, edhe pse si viktimë e rastit, gjyqtari ekzekutues nuk është paraqitur në seancën e konfirmimit. I pandehuri ka deklaruar para gjyqtarit për konfirmimin e

²² Ushtria Çlirimtare e Kosovës.

²³ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/25, për Kodin e përkohshëm penal të Kosovës (KPPK), 6 korrik 2003, neni 316(2).

²⁴ KPPK, neni 267(1).

aktakuzës se gjyqtari ekzekutues ishte përgjegjës për rastin dhe e ka akuzuar për bashkëpunim me regjimin serb.

Fatkeqësisht, përkundër provave të qarta të frikësimit të gjyqtarit dhe dëshmitarëve, as prokurori e as gjyqtari nuk kanë kërkuar masa mbrojtëse për gjyqtarin ekzekutues para seancës së konfirmimit.

Shumë dispozita të KPPK-së për mbrojtjen e dëshmitarëve nuk kanë qenë të dobishme (siç janë, dëshmia anonime ose gjykimi jopublik), për shkak se dëshmitari/viktima është një gjyqtar ekzekutues i njohur mirë në Gjykatën Komunale të Prishtinës/Priština. Gjithashtu, nuk ka gjasa se gjyqtari do të futej në listën e programit për mbrojtjen e dëshmitarëve, për shkak se nuk bëhej fjalë për ndonjë rast të krimit të organizuar, trafikim, ose krime lufte që në mënyrë tipike do të hynte në kuadër të fushëveprimit të NJMD-së.

Mirëpo, policia ka mundur t'i ofrojë gjyqtarit ekzekutues një mbrojtje speciale, ose sipas KPPK-së, i pandehuri ka mundur të ndahet fizikisht nga dëshmitari gjatë dëgjimit. Dështimi për mbrojtjen e dëshmitarit kyç të prokurorisë, ka rezultuar me mos-paraqitjen ose mos-bashkëpunimin e tij, dhe përfundimisht ka penguar ndarjen e drejtësisë në këtë rast.

Në të njëjtin rast, dëshmitë sugjerojnë se dëshmitarët tjerë potencialë, gjegjësisht pjesëtarët e Shërbimit Policor të Kosovës (SHPK-së) kanë mundur të jenë frikësuar:

Gjatë përpjekjes për ekzekutimin e dëbimit, që ka ndodhur me 14 nëntor 2005, gjyqtari ekzekutues ka qenë i shoqëruar nga tre oficerë të SHPK-së dhe dy nëpunës të gjykatës. Gjithashtu prezent ishin dy pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës të cilët e kishin kërkuar ekzekutimin. Gjatë ekzekutimit të dëbimit, gjyqtari i përmbarimeve gjoja ishte sulmuar nga një individ i cili kundërshtonte dëbimin. Mirëpo, pasi që ngjau sulmi i pandehur, oficerët e SHPK-së dhe nëpunësit e gjykatave kanë mohuar përdorimin e forcës ose dhunës nga kryerësi i supozuar, për dallim nga deklaratat e bëra nga gjyqtari ekzekutues dhe nga pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës.

Prokurori ndërkombëtar i ka akuzuar tre oficerë të SHPK-së për veprën penale të mos lajmërimit të veprës penale,²⁵ dhënie të ndihmës kryerësve²⁶ dhe deklaram të rrejshëm.²⁷ Gjatë seancës së mbajtur me 12 shtator 2006, gjyqtari ndërkombëtar e ka konfirmuar aktakuzën me të gjitha pikat e saj kundër të gjithë të pandehurve.

Deklaratat e oficerëve të SHPK-së janë në kundërshtim me deklaratat e gjyqtarit ekzekutues dhe dy anëtarëve të komunitetit serb të Kosovës që ishin të pranishëm gjatë ekzekutimit të dëbimit. Nëse pretendimet e mëvonshme për sulm janë të vërteta, është e mundur që oficerët e SHPK-së dhe nëpunësi të jenë frikësuar.

²⁵ KPPK, neni 304(2).

²⁶ KPPK, neni 305(1).

²⁷ KPPK, neni 307(1).

OSBE gjithashtu ka përcjellë një rast problematik, ku dëshmitari kyç i prokurorisë është vrarë dhe është sulmuar dëshmitari anonim në Prizren, nga gjykimi për krime të luftës para kolegjit prej gjyqtarëve ndërkombëtar në Gjilan/Gnjilane:

Në ditën e 10 tetorit 2005, në tregun e Xërxës/Zerze, rajoni i Prizrenit, dy individë e kanë vrarë dëshmitarin kyç të prokurorisë dhe ka lënduar rëndë dëshmitarin anonim. Individë të panjohur e kanë zhgroposur nga varri trupin e varrosur të viktimës/ish-dëshmitarit dhe e kanë djegur. Pamfletet ishin shpërndarë në të mirë të Armatës Kombëtare Shqiptare (AKSH),²⁸ anekënd rajonit të Rahovecit/Orahovac.

Në pamflete thuhej: “Shpallje – Ne i njoftojmë qytetarët e Kosovës se AKSH e merr përsipër vrasjen e [...]”²⁹ me 10/10/2005, dhe nuk do ta ndalë ekzekutimin e të gjithë bashkëpunëtorëve siç janë personat e lartpërmendur, si dhe të atyre që nuk i përmbushin kërkesat tona....” Prokurori ndërkombëtar e kishte marrë lëndën dhe megjithëse identiteti i të dyshuarve kryesorë ishte (njëri prej tyre ish-pjesëtarë i UÇK-së) ishte mirë i njohur, që nga shtatori 2006 nuk janë bërë arrestime ose veprime hetimore.

Në bazë të intervistës të mbajtur në shtator 2006, të zhvilluar nga OSBE-ja me një anëtarë të ekipit hetues dhe ligjor, hezitimi i popullatës vendore për të bashkëpunuar (frika nga hakmarrja dhe admirimi për dy të dyshuarit kryesorë) është problemi kryesor i këtij rasti. Edhe nëse do ishin të gatshëm të dëshmojnë ose bashkëpunojnë, publiku nuk ka besim në autoritetet se ato do t’i mbrojnë në mënyrë efektive ata nga hakmarrja e të dyshuarve. Kjo parqet vështirësi në sigurimin e provave relevante, pasi që publiku nuk ka besim në sistemin e drejtësisë i cili nuk do t’i mbrojë si duhet.

Gazetaria e papërgjegjshme ka penguar gjithashtu mbrojtjen e dëshmitarëve, ngase OSBE ka shënuar raste kur gazetatat kanë zbuluar identitetin e “dëshmitarëve anonimë”. Për shembull, në rastin e sipërm të Xërxës/Zerze, gazeta lokale,³⁰ kur ka raportuar për sulmin ndaj dy dëshmitarëve të gjyqimit për krime lufte, ka zbuluar identitetin e dëshmitarit anonim. Rrjedhimisht, në seancën e gjyqimit të datës 15 dhjetor 2005 dëshmitari “anonim” ka dëshmuar haptazi ngase tanimë publiku e kishte mësuar identitetin e tij.

B. Kërcënimet ndaj viktimave të veprave penale kundër integritetit seksual

OSBE gjithashtu ka parë prova të frikësimeve të mundshme ndaj dëshmitarëve në rastet e krimeve të supozuara kundër integritetit seksual dhe trafikimit. Në këto raste, viktimat/dëshmitarët zakonisht i ndryshojnë deklaratimet fillestare të inkriminimit të të dyshuarve gjatë dëgjimeve në fazën e hetimeve, dhe pastaj i shfajësojnë ata gjatë gjyqimit. Ky ndërrim i deklaratës paraqet provë se i pandehuri ka mundur ta kërcënojë viktimën/dëshmitarin. Një rast para gjykatës së qarkut në Prizren në vitin 2005, mund të shërbejë si shembull:

²⁸ *Armata Kombëtare Shqiptare (AKSH)*. Shiko Udhëzimin Administrativ Nr. 2003/9 që implementon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/12 mbi Ndalimin e Terrorizmit dhe Krimeve të tjera të Ngjashme, 17 Prill 2003

²⁹ OSBE me qëllim nuk e përmend emrin e viktimës.

³⁰ *Lajm*.

Prokurori i ka akuzuar dy persona për keqpërdorim seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet³¹ dhe mundësim të prostitucionit.³² Disa prej viktimave/dëshmitarëve e kanë ndryshuar deklaratën e tyre prej deklaratës me të cilën i akuzojnë të pandehurit gjatë fazës së hetimeve, në deklaratë shfajësuese gjatë gjykimit. Gjatë gjykimit, një nga viktimat/dëshmitarët ka zbuluar se të pandehurit e kishin prangosur dhe lënduar rëndë atë, për ta detyruar të mos dëshmojë ose për ta ndryshuar deklaratën e saj.

OSBE ka mësuar se asnjë prokuror, ose personat tjerë të autorizuar për këtë sipas KPPK-së, nuk kanë propozuar masat mbrojtëse ashtu siç do të ishte e përshtatshme në këtë rast.³³ Mirëpo, nga një aspekt pozitiv, aktgjykimi e ka shpallur njërën prej të pandehurve fajtor për “pengim të provuarit”³⁴ (ku përfshihet edhe kërcënimi i dëshmitarit që të jep deklaratë të rrejshme).

OSBE e ka përcjellë një rast tjetër të veprës penale ndaj integritetit seksual me frikësim të mundshëm të viktimës/dëshmitarit në Gjykatën e Qarkut të Pejës/Pec:

Me 19 korrik 2006, policia e ka arrestuar një njeri nën dyshimin e përdhunimit të një vajze. Me 21 korrik 2006, me kërkesën e prokurorit, gjyqtari i procedurës paraprake ka urdhëruar paraburgimin e të pandehurit për një muaj. Gjatë hetimeve, me 1 gusht 2006, prokurori, në praninë e mbrojtësit, e ka dëgjuar palën e dëmtuar/viktimën duke e akuzuar të pandehurin se e ka përdhunuar.

Në ankesën kundër paraburgimit, avokati i të pandehurit ka propozuar lirimin e klientit të tij pjesërisht për shkak se dy familjet – e viktimës dhe e të pandehurit – janë “pajtuar”. Dokumenti i quajtur “dokumenti i pajtimit” në shkresat e lëndës të nënshkruar nga pala e dëmtuar/viktima, thekson se viktima ka pranuar 5.000 nga i pandehuri.

Fakti që dëshmitari/viktima e akuzoi të pandehurin për dhunim, krim brutal e zvogëlon mundësinë të jetë arritur “pajtimi” i vërtetë midis familjeve. Në vend të kësaj, marrja e parave dhe marrëveshja mund të reflektojë se familja e vajzës ose e të pandehurit i ka bërë asaj presion që ta nënshkruaj marrëveshjen. Është e rëndësishme se as prokurori publik e as pala tjetër e autorizuar nuk ka kërkuar mbrojtje speciale për viktimën/dëshmitaren.

OSBE gjithashtu ka vërejtur frikësime të mundshme të dëshmitarëve në rastet e supozuara të trafikimit.

Në tetor 2006, në një hetim të zhvilluar nga prokuroria e qarkut të Prizrenit, për veprën penale të trafikimit me njerëz,³⁵ dy nga viktimat e supozuara nga

³¹ KPPK, neni 198.

³² KPPK, neni 201(3) dhe (4). Pikat e aktakuzës përfshijnë gjithashtu edhe krimet tjera, siç janë pengimi i të provuarit (KPPK, neni 309) dhe ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore (KPPK, neni 221).

³³ Shih KPPK, neni 169(1).

³⁴ KPPK, neni 309.

³⁵ KPPK, neni 139.

Moldavia në fillim kanë dhënë deklaratat para policisë, ku e pranojnë se kanë hyrë më marrëdhënie seksuale me klientët e barit, në pronësinë e njërit nga të pandehurit, të cilët e merrnin një pjesë të fitimit. Mirëpo, kur prokurori i ka marrë në pyetje më vonë, viktimat/dëshmitarët kanë mohuar se kanë dhënë vullnetarisht shërbime seksuale me të holla.

Është e paqartë nëse frikësimi i dëshmitarëve ose ndonjë motiv tjetër (p.sh., frika se ato mund të dënohen për ushtrimin e prostitucionit)³⁶ ka rezultuar në ndryshim të deklaratës. Duhet shënuar se prokurori nuk ka kërkuar ndonjë masë mbrojtëse për viktimat e supozuara të trafikimit.

IV. REKOMANDIMET

Për autoritetet vendore dhe ndërkombëtare si UNMIK-u, Ministria e Drejtësisë, Parlamenti i Kosovës dhe Shërbimi Policor i Kosovës:

- Të themelohet Zyra ndërlidhëse për mbrojtjen e dëshmitarëve e cila do të ketë funksionet kryesore, gjetjen e shteteve që janë të gatshme t'i pranojnë dëshmitarët e Kosovës që duhet të zhvendosen;
- Për rastet më serioze penale, të themelohet një program më formal dhe i hollësishëm dhe me buxhet të ndarë, me ç'rast dëshmitarët dhe familjet e tyre do të mund të zhvendoseshin jashtë Kosovës, me identitet të ndryshuar pas vlerësimeve të “kërcënimit” dhe “përshtatshmërisë për hyrje në program”;
- Të krijohen procedura në Kosovë me të cilat programet për zhvendosjen e dëshmitarëve bëhen të pavarura financiarisht dhe të qëndrueshme – *p.sh.*, duke përdorur përfitimin material të konfiskuar nga rastet penale me qëllim të financimit dhe mirëmbajtjes së programit për zhvendosje të dëshmitarëve;
- Të arrihet ndryshimi i identitetit të dëshmitarit në atë mënyrë sa të pengojë zbulimin e identitetit të ri brenda dhe jashtë Kosovës. Për më shumë, të prezantohen ndryshime ligjore për të siguruar se nuk ka qasje publiku dhe shërbyesit tjerë civilë në të dhënat e Zyrës për regjistrim civil;
- Të zhvillohet një sistem i arkivimit, shkëmbimit, deponimit, ruajtjes dhe përfundimisht shkatërrimit të informatave të ndjeshme përkitazi me aktivitetin e NJMD-së dhe mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Legjislacioni të ndryshohet në atë mënyrë që të kërkohet nga policia, prokurori apo gjykata të informoj çdo dëshmitarë mbi masat në dispozicion për mbrojtjen e dëshmitarëve.
- Të ndryshohet legjislacioni që të prezantohen dënime të rrepta kundër gazetave të cilat e zbulojnë identitetin e dëshmitarëve anonim ose dëshmitarëve të mbrojtur;

³⁶ Në Kosovë, prostitucioni dënohet si kundërvajtje. Shih Ligin për qetësinë dhe rendin publik (Gazeta zyrtare e KSAK, nr. 13/81), neni 18(1) pika 6.

- Të ngritët vetëdija e publikut -- p.sh. përmes afishimeve në panolla, gazeta ose reklamave televizive lidhur me -- detyrën ligjore dhe morale të individëve për të dëshmuar në procedura penale dhe civile;
- Të zhvillohen mekanizma për mbrojtjen e informatave të fshehta të dëshmitarëve.

Për gjyqtarët dhe prokurorët:

- Të zbatohen metodat ekzistuese për mbrojtjen e dëshmitarëve të parapare në KPPPK (p.sh., përdorimi i deklaratave anonime dhe dëshmia nga distanca, seancat jopublike, ndarja fizike e dëshmitarit nga i pandehuri);
- Individët të cilët kërcënojnë ose frikësojnë dëshmitarët duhet të ndiqen penalisht dhe të dënohen;
- Të zhvillohen mekanizma për ruajtjen e informatave të fshehta të dëshmitarëve.

Për policinë:

- Të mbroj dëshmitarë para, gjatë dhe pas gjykimit;
- Të koordinojë me prokurorët informimin e dëshmitarëve potencial lidhur me metodat në dispozicion për mbrojtjen e dëshmitarëve në Kosovë dhe bashkërisht të ndihmojnë në aplikimin e metodave për mbrojtjen e dëshmitarëve;

Për autoritetet e burgjeve:

- Dëshmitarët e mbrojtur (të cilat janë bashkë të pandehur) të ruhen në objekte tjera të paraburgimit, ndarazi nga pjesa tjetër e popullatës së burgut.

Për gazetat dhe mediat:

- Të përmbahen nga zbulimi i identitetit të dëshmitarëve anonim dhe të mbrojtur dhe publikimit të informatave të ndjeshme në lidhje me dëshmitarët.

Për Institutin Gjyqësor të Kosovës (IGJK) dhe institucionet tjera trajnuese:

- Të organizoj trajnime për policinë, prokurorët dhe gjyqtarët mbi metodat e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Kapitulli 2

ADMINISTRIMI I DREJTËSISË NË GJYKATAT PËR KUNDËRVAJTJE

Në Kosovë, për momentin ekzistojnë 25 gjykata për kundërvajtje (GJK) në sistemin juridik.³⁷ Juridiksioni i GJK-ve mbulon disa fusha siç është rendi dhe qetësia publike, siguria në trafik, lëvizja e personave, ekonomia dhe financat, arsimi, shkenca, kultura dhe informimi, mjedisi, shëndetësia dhe mbrojtja sociale.³⁸ Fushëveprimi i gjerë i juridiksionit të GJK-ve e bënë atë pjesë të rëndësishme të sistemit juridik në Kosovë.

Megjithatë, në monitorimin e këtyre gjykatave, OSBE-ja ka vërejtur një sërë shkeljesh të ligjit vendës dhe standardeve për të drejtat e njeriut. Kërkesave për inicim të procedurës (shpeshherë të hartuara nga policia) të paraqitura në GJK shpeshherë u mungojnë informata të domosdoshme, përmbajnë dorëshkrim të palexueshëm dhe përfshijnë referenca të gabuara akuzës përkatëse në bazë të ligjit për kundërvajtje.³⁹

OSBE-ja gjithashtu ka vërejtur se shumë vendime të GJK-ve kanë probleme me arsyetim dhe organizim të dobët apo të papërfunduar. Shpeshherë, vendimet e GJK-ve që kanë të bëjnë me disa të pandehur përfshijnë dënime kolektive të cilat nuk specifikojnë nivelin e përgjegjësisë së secilit të pandehur. OSBE-ja gjithashtu ka monitoruar rastet në të cilat gjykatat komunale dhe të qarkut në Kosovë ndjekin penalisht individët për sjelljen e tyre që buron nga të njëjtat fakte të pohuara pasi që GJK-ja të ketë nxjerrë vendim të formës së prerë kundër të pandehurit. Kjo shkel parimin *ne bis in idem* (gjithashtu të njohur si ndalimi i gjykimit të dyfishtë për të njëjtën vepër penale).

I. KORNIZA LIGJORE

A. Ligji për Gjykatat e Kundërvajtjes në Kosovë

Në bazë të legjisllacionit të tanishëm në fuqi të Kosovës, “[Kundërvajtjet] janë shkelje të rendit publik të përkufizuar me ligj apo rregulloret tjera për të cilat parashikohen

³⁷ Instituti Gjyqësor i Kosovës, Raporti për Punën e Gjykatave për Kundërvajtje, çerek vjetori i dytë 2006.

³⁸ Përpos ligjit për rendin dhe qetësinë publike (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 13/81 më tutje e njohur si LRQP), ligjet të cilat krijojnë kundërvajtjet janë *p.sh* ligji për realizimin e barazisë së gjuhëve dhe alfabetëve në Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 48/77, shih nenin 44), ligji për bazat e sigurisë në trafik në rrugët e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (Gazeta zyrtare e RSF Jugosllavisë, Nr. 50/88 dhe 63/88), ligji për sigurinë në trafik në rrugët e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (Gazeta zyrtare e KSA të Kosovës Nr. 5/84 dhe 7/86), ligji për pylltarinë e Kosovës (Ligji Nr. 2003/3 shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2003/6, 20 mars 2003), Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/16 *për lëvizjen e personave brenda dhe jashtë Kosovës*, 8 prill 2005.

³⁹ Lexo ligjin për kundërvajtje të Republikës Socialiste të Serbisë (më tutje LKS – Informatori Zyrtar i RS të Serbisë, Nr. 6/79), Ligji për kundërvajtje i Kosovës (më tutje LKK Gazeta zyrtare e KSA Kosovës Nr. 23/79), Ligji për ndryshimet në ligjin për kundërvajtje (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 44/84, 18/87, 9/88 dhe 21/88). Disa nene të LKS zbatohen në Kosovë (shih nenet -21: 29-30:289-293).

dënime dhe masa mbrojtëse”.⁴⁰ Kundërvajtjet mund të “parashikohen me ligj, rregullore dhe vendim të kuvendit komunal”.⁴¹

Disa ligje të cilat rregullojnë aspektet e ndryshme të shoqërisë përkufizojnë se çfarë sjellje përbën kundërvajtje në Kosovë.⁴² Dënimet e shqiptuara për kundërvajtje mund të rezultojnë në dënim me burgim deri në 60 ditë apo në dënime me para.⁴³

Përderisa ligji i Kosovës përshkruan kërkesat procedurale lidhur me procedurat në gjykatat për kundërvajtje, praktika gjyqësore e GjEDNJ urdhëron kërkesa shtesë varur nga ajo nëse vepra është penale sipas praktikës gjyqësore të GjEDNJ-së.

B. Klasifikimi i kundërvajtjeve si vepra penale në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ

Përderisa organet publike munden të klasifikojnë rastet në bazë të ligjit vendës si penale, disiplinore apo administrative në bazë të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, tre faktorë do të përcaktojnë nëse çështja është penale dhe nëse i pandehuri duhet të pranojë mbrojtjet për gjykim të drejtë në bazë të nenit 6 (1) të KEDNJ-së. Këta faktorë përfshijnë klasifikimin e veprës në legjislationin vendës, natyrën e veprës dhe shkallën dhe intensitetin e dënimit.⁴⁴

i) Klasifikimi i veprës

Nëse vepra është e klasifikuar si vepër penale sipas ligjit vendor, do të zbatohet neni 6 i KEDNJ. Megjithatë, edhe nëse një vepër nuk kategorizohet si penale sipas ligjit vendor, klasifikimi është “vetëm një pikë fillestare,”⁴⁵ dhe nëse dy kriteret tjera në mënyrë thelbësore se vepra është akuzë penale⁴⁶ duhet të respektohen kërkesat e KEDNJ për gjykim të drejtë.

ii) Natyra e veprës

Në përcaktimin se një vepër është penale, në vend se disiplinore ose administrative, praktika gjyqësore e GjEDNJ merr parasysh se për kë zbatohet ligji, si dhe qëllimin e dënimit.

⁴⁰ Neni 1, Ligji për Kundërvajtje i Serbisë (LKS).

⁴¹ Neni 3, LKS.

⁴² Lexo *supra* at 40

⁴³ Shiko nenet 2 dhe 3, LKK.

⁴⁴ *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, aktgjykimi nr. 5100/71 et al., 8 qershor 1976, para. 82; *Ozturk v. Gjermanisë*, aktgjykimi nr. 8544/79, 21 shkurt 1984, paragrafi 50.

⁴⁵ *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, *id.*

⁴⁶ *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, *id.*, paragrafët 81-82 (“nëse shtetet kontraktuese do të kishin pasur mundësi sipas diskrecionit të tyre të klasifikojnë si disiplinore në vend të veprës penale, ose ta ndjekin penalisht autorin e veprës së ‘përzier’ në planin disiplinor e jo penal, operimi i artikullit të neneve 6 dhe 7 do të lihej nën sovranitetin e shteteve. Zgjerimi mund të shpie deri te rezultati i cili nuk është në përputhje me qëllimin dhe objektivin e Konventës.”); *Ozturk kundër Gjermanisë*, *id.*, para. 53 (“do të ishte kundër qëllimit dhe objektivit të nenit 6, që iu garanton secilit që është i ngarkuar me vepër penale, të ketë të drejtë të paraqitet para gjykatës dhe të ketë gjykim të drejtë, nëse shtetet do t’iu lejohej që të mënjanojnë nga spektri i këtij neni (neni 6), e tërë kategoria e veprës do të ishte thjesht e bazuar në natyrë të ngushtë.”).

Në përgjithësi, nëse ligji zbatohet vetëm për një grup të popullatës, si është ai që iu përket grupit profesional, vepra mund të klasifikohet më shumë se është e natyrës disiplinore se sa penale sipas nenit 6.⁴⁷

Nëse dënimi është si i natyrës parandaluese, ashtu edhe i natyrës ndëshkimore, do të klasifikohet më shumë si penale se sa administrative ose disiplinore.⁴⁸ Për shembull, në rastin *Ozturk kundër Gjermanisë*, GJEDNJ është e mendimit se, vepra e vozitjes me neglizhencë, që në Gjermani nuk është më vepër penale, sipas nenit 6 pjesërisht ka qenë penale për shkak se dënimi është shqiptuar (gjoba) sipas natyrës parandaluese dhe ndëshkuese.⁴⁹

iii) *Natyra dhe pesha e dënimit*

Faktori i tretë që merret parasysh nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në përcaktimin se a zbatohet neni 6 i KEDNJ-së për veprën penale, është natyra dhe pesha e dënimit.

Privimi nga liria si dënim në përgjithësi e bënë një vepër më shumë penale, se sa disiplinore ose administrative.⁵⁰ Kërcënimi me burg, pa marr parasysh se a është shqiptuar apo jo, e bënë të zbatueshëm nenin 6 të KEDNJ.⁵¹

Kur dënimi potencial nuk është me burg, por me gjobë, GJEDNJ merr parasysh se a është kjo gjobë kompensim për dëmin, ose dënim për të parandaluar veprën në të ardhmen. Vetëm në rastin e fundit vepra është e konsideruar të jetë penale.⁵²

Rrjedhimisht, nga aspekti i praktikës gjyqësore të GJEDNJ, shumë nga kundërvajtjet në Kosovë do duhej të kualifikoheshin si vepra penale sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, për shkak se prej natyrës, ato janë vepra penale

⁴⁷ Shiko *Ozturk kundër Gjermanisë*, *id.*, para. 53 (që e klasifikon veprën në komunikacion si penale pjesërisht për shkak se është bërë drejt “të gjithë qytetarëve që janë në kapacitetin e shfrytëzuesve të rrugës”); Shiko *Weber kundër Zvicrës*, aktgjykimi nr. 11034/84, 22 maj 1990, para. 33 (“dënimet disiplinore në përgjithësi janë të sajura për të siguruar që anëtarët e grupeve të veçanta të respektojnë rregullat specifike që përcjellin sjelljet e tyre [...] Pasi neni 185, megjithatë, ndikon potencialisht në tërë popullatën, vepra me të cilën e definojnë, dhe të cilës ia bashkon dënimin ndëshkues, është vepër penale për qëllime të kriterit të dytë.”)

⁴⁸ *Ozturk kundër Gjermanisë*, aktgjykimi nr. 8544/79, 21 shkurt 1984, para. 53.

⁴⁹ Në rastin *Ozturk kundër Gjermanisë*, *id.*, para. 53 GJEDNJ citon se “sipas kuptimit të zakonshëm të termeve, në përgjithësi bie kufirin e ligjit penal veprat të cilat e bëjnë që kryesi i veprave të dënohet sipas dënimeve që ka qenë qëllimi, *inter alia*, të jenë më shumë parandaluese dhe të jenë masë për privimin e personit nga liria e tij.”

⁵⁰ *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, *supra* at 46 para. 82 (“Në një shoqëri të nënshtruar sundimit të ligjit, i përkasin edhe privimet e lirisë në sferën ‘penale’ që mund të shqiptohen si dënim, përveç atyre që nga natyra e tyre, nuk mund të përcaktohen kohëzgjatja dhe mënyra e ekzekutimit. Serioziteti që është në një pikë kyçe, traditat e shteteve kontraktuese dhe rëndësia e bashkangjitur në konventë për të respektuar lirinë fizike të personave, kërkohet të jetë kështu [...]”). Megjithatë, sipas një rasti gjyqësor në GJEDNJ, nuk është çdo rast që e bënë të zbatueshëm nenin 6 të KEDNJ. Gjykata, në paragrafin 85 të të njëjtit vendim është e mendimit se kohëzgjatja e dënimit me burg prej dy ditëve ka qenë i pamjaftueshëm për t’u konsideruar rasti si dënim penal.

⁵¹ Në rastin *Engel dhe të tjerët kundër Holandës*, *id.*, para. 85, fakti se njëri prej të pandehurve kishte marrë dënimin që nuk kishte qenë privim lirie nuk e kishte kualifikuar veprën si jo penale për shkak se rezultatet nuk mund të “zhvlerësojnë rëndësinë e asaj që kishte qenë fillimisht kyçe.”

⁵² *Bendenoun kundër Francës*, aktgjykimi nr. 12547/86, 24 shkurt 1994, para. 47.

(për shembull, zbatohen përgjithësisht në publik) dhe kanë dënime të cilat shërbejnë si parandaluese kundër veprave penale në të ardhmen dhe shpesh ato janë privim nga liria (për shembull dënimi me burg). Kjo do të përfshinte të gjitha veprat e kundërvajtjes sipas Ligjit mbi rendin dhe qetësinë publike-LRQP⁵³, që mund të rezultojë me dënim me burg, dhe shumë prej veprave kanë të bëjnë me komunikacionin dhe sigurinë në rrugë.⁵⁴

Kështu që, kurdo që procedurat mbahen në gjykatat komunale për veprat të cilat do të definoreshin si penale sipas precedentit juridik të KEDNJ-së, gjyqtarët duhet të zbatojnë standardet ndërkombëtare për gjykim të drejt, për procedurat penale siç kërkohet edhe me Konventat rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,⁵⁵ që janë të zbatueshme në Kosovë.⁵⁶

Krahas kësaj, për veprat të cilat do të kualifikoheshin si vepra penale sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, ligji mbi kundërvajtje duhet të ndërrohet në mënyrë që procedurat të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁵⁷

II. SHKELJET E VËZHGUARA TË LIGJIT VENDOR DHE STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

A. Mungesa ose definicioni i gabueshëm i akuzave në kërkesën për fillimin e procedurës

Sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, një person i akuzuar për vepër penale duhet të informohet saktë, në gjuhën në të cilën ai/ajo e kupton dhe në detaje, të informohet për natyrën dhe arsyet e akuzave kundër tij/saj.⁵⁸ Komiteti për të drejtat e njeriut ka cituar se informata e ofruar personit të akuzuar për vepër penale duhet të cekë “si ligjin, ashtu edhe faktet e supozuara mbi të cilat është bazuar [akuza].”⁵⁹

⁵³ Nenet 18-23, LRQP.

⁵⁴ Shiko, për shembull, nenet 226-227, Ligjin mbi bazat e sigurisë së komunikacionit nëpër rrugët e RSFJ-së (Gazeta zyrtare RSFJ-së nr. 50/88 dhe 63/88); nenet 200-201, Ligjin mbi bazat e sigurisë së komunikacionit nëpër rrugët e KSAK (Gazeta zyrtare e KSAK, nr. 5/84 dhe 7/86).

⁵⁵ Për paktet ndërkombëtare, *shiko për shembull*, Paktin ndërkombëtar mbi të drejtat politike dhe civile (PNDPC/ICCPR), Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB 2200A (XXI), 16 dhjetor 1966, neni 14. Për nivelin rajonal, *shiko* Konventën evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, të adoptuar në Romë më 4 nëntor 1950, neni 6.

⁵⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 *Mbi Ligjin e zbatueshëm në Kosovë*, 12 dhjetor 1999 (të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59 të 27 tetorit 2000), neni 1.3; Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 *Mbi Kornizën Kushtetuese për Institucionet e përkohshme për Vetëqeverisje në Kosovë*, 15 maj 2001, neni 3.2.

⁵⁷ Sekretari i Përgjithshëm i KB e kishte përsëritur këtë rekomandim në raportin e tij të vitit 1999 mbi Administratën e përkohshme në Kosovë. “UNMIK-u do të fillojë procesin e ndryshimit të legjislacionit, sipas nevojës, duke përfshirë [...] ligjin mbi rendin dhe qetësinë publike, në mënyrën që është e qëndrueshme me qëllimet e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të KB 1244 (1999) dhe me standardet e njohura ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut.” *Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Administratën e Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë*, Dok. i KB S/1999/779, 12 korrik 1999, para. 75.

⁵⁸ Neni 14 (1) (a) PNDPC, neni 6 (3) (a) KEDNJ.

⁵⁹ Komiteti për të drejtat e njeriut, Komenti i Përgjithshëm nr. 13, para. 8.

“Natyra” e akuzës i referohet karakterit ligjor ose klasifikimit të fakteve, përderisa “arsyet e akuzës” i referohet fakteve të cilat e formojnë bazën e akuzës.⁶⁰ Krahas kësaj, e drejta për t’u informuar saktësisht për natyrën dhe për shkakun e akuzës ka për qëllim që t’i ofrojë personit të interesuar informatat e nevojshme për mbrojtjen e tij/saj.⁶¹ Kështu, ekziston një ndërlidhje në mes së drejtës për t’u informuar saktësisht për çfarëdo akuze, dhe të drejtës për të pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen.⁶² Pajtueshmëria me të parën është kusht i nevojshëm për pajtueshmërinë me të dytën.⁶³

LK parashikon se “[d]uhet të parashtrohet kërkesa për fillimin e procedurës me shkrim dhe duhet të përmbajë informatat siç janë emri i të akuzuarit, pretendimet faktike, dëshmia e propozuar[...].”⁶⁴ dhe “kualifikimi ligjor i veprës”.⁶⁵ Intervistat me kryetarët e GJK në tërë territorin e Kosovës tregojnë se, sipas rastit, policia dhe GJK nuk bashkëpunojnë dhe kjo mund të ndikojë negativisht në procedurat e Gjykatave për Kundërvajtje. Për shembull, shpesh policia nuk i korrigjojnë mangësitë në kërkesa për mbajtjen e procedurës së veprës penale në rast kur GJK e kthen kërkesën. Veç kësaj, nganjëherë policët nuk i përgjigjen thirrjeve nga gjykata ose nuk i ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Ligji vendor urdhëron që nëse kërkesa për fillimin e procedurës nuk i përmban të dhënat e kërkuara “duhet t’i kthehet parashtruesit të kërkesës për t’i plotësuar mungesat në afat të caktuar kohor” që “nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë”.⁶⁶ Krahas kësaj, ligji thekson se “nëse parashtruesi i kërkesës nuk i mënjanon mungesat në afat të caktuar kohor, do të konsiderohet se ai/ajo e ka hequr dorë nga kërkesa, kështu që kërkesa e tillë do të refuzohet me vendim.”⁶⁷

Edhe përkundër këtyre urdhëresave ligjore, OSBE kishte monitoruar rastet ku kërkohet fillimi i procedurës para gjykatës për kundërvajtje (shpeshherë të hartuara nga policia) nuk i kishte përshkruar pretendimet faktike, ose kualifikimet ligjore siç kërkohen me Ligjin për Kundërvajtje.

Për shembull, me 8 qershor të vitit 2006, SHPK në Mitrovicën/Mitrovica jugore kishte parashtruar një kërkesë për të filluar procedurën gjykatën për kundërvajtje kundër një individi i cili supozohej se e kishte sulmuar një polic gjatë një ngjarje sportive. Edhe pse kërkesa ishte bazuar në dispozitë që nuk ekziston në Ligj,⁶⁸ gjykata e kishte shpallur të pandehurin fajtor dhe duke zbatuar dispozitën e duhur të ligjit të cilën policia nuk ia kishte qëlluar, dhe e

⁶⁰ Shiko *X kundër Belgjikës*, Vendimi i Komisionit për zbatim nr. 7628/76, 9 maj 1977, faqe 169; shiko gjithashtu edhe *Offner kundër Austrisë*, Vendimi i Komisionit për zbatim nr. 524/59, 19 dhjetor 1960.

⁶¹ Shiko *Bricmont kundër Belgjikës*, Vendimi i Komisionit për zbatim nr. 10857/84, 48 DR 106, 15 korrik 1986.

⁶² Neni 14 (1) (b) PNDCP, neni 6 (3) (b) KEDNJ

⁶³ Shiko *Offner kundër Austrisë*, Vendimi i Komisionit për zbatim nr. 524/59, 3 YB 322, 19 dhjetor 1960, 344.

⁶⁴ Neni 135 para. 1, LKK

⁶⁵ Neni 135 paragraf 1 pika 3, LKK..

⁶⁶ Neni 135 para. 2 dhe 3, LKK.

⁶⁷ Neni 135 para. 2, LKK.

⁶⁸ Raporti i policisë i referohet nenit 18 (5) dhe (10), përderisa do të duhej të i referohet nenit 18 (1) pikës 5 të LRQP.

kishte dënuar atë me 60 ditë burg. Duke vepruar kështu, gjyqtari e kishte modifikuar *ex officio* përmbajtjen e kërkesës origjinale të parashtruar nga SHPK.

Në rastin e dytë me 3 maj të vitit 2006, SHPK kishte parashtruar një kërkesë për fillimin e procedurës kundër dy personave në Gjykatën për Kundërvajtje në Istog/Istok për shkak se supozohet që ata e kishin prishur rendin dhe qetësinë publike duke u rrahur. Kërkesa nuk kishte paraqitur se çfarë vepre kishin kryer të pandehurit. Megjithatë, gjatë seancës së 16 majit 2006, gjyqtari i kishte marrë në pyetje të pandehurit dhe disa dëshmitarë, i kishte shpallur fajtorë,⁶⁹ dhe i kishte dënuar ata me gjobë prej 50 eurosh për secilin.⁷⁰

Në rastin e tretë, me 30 korrik të vitit 2005, SHPK e kishte parashtruar një kërkesë për mbajtjen e procedurës kundërvajtëse kundër disa njerëzve para Gjykatës për Kundërvajtje në Vushtrri/Vučitrn, të cilët me 29 korrik të vitit 2005, kishin shkruar grafitë nëpër muret e ndërtesave private dhe shoqërore. Me 31 gusht 2005, Gjykata për Kundërvajtje në Vushtrri/Vučitrn i kishte transferuar rastet kundër disa të pandehurve nëpër gjykatat tjera për kundërvajtje në Kosovë⁷¹ (Mitrovicë/Mitrovica, Prishtinë/Priština, Lypjan/Lipljane, dhe Suharekë/Suva Reka). Në këtë rast, kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk e kishte cekur veprën e supozuar penale. Që nga shtatori i vitit 2006, procedura para Gjykatës për Kundërvajtje në Vushtrri/Vučitrn ende nuk është përfunduar.

Këta shembuj paraqesin dështimin e policisë për ta kualifikuar veprën në mënyrë të drejtë me rastin e paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës ligjore para gjykatave për kundërvajtje. Krahas kësaj, gjyqtarët nuk i kishin zbatuar rregullat procedurale që kërkojnë që dokumentet jo të rregullta të kthehen në polici të cilët duhet t'i plotësojnë me të gjitha informatat e kërkuara.

OSBE beson se në rastet e sipërpërmendura, gjykatat kanë shkelur të drejtat e të pandehurve për t'u informuar në mënyrë të saktë në detaje për natyrën e pretendimeve faktike dhe ligjore, si dhe të kenë kohë të mjaftueshme për ta përgatitur mbrojtjen.

B. Mungesa e vendimeve të arsyetuara

Sipas standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut,⁷² kërkesa për gjykim të drejtë supozon se gjykata do të jep arsyetimin për aktgjykim. Praktika gjyqësore e GJEDNJ thekson se, përderisa gjykatat vendore kanë liri të gjerë veprimi sa i përket strukturës dhe përmbajtjes së vendimit, gjykatat duhet të “cekin me qartësi të mjaftueshme bazat mbi të cilat e kanë marrë vendimin”⁷³ për shkak se “[...] një vendim me arsyetim i jep

⁶⁹ Sipas nenit 18 (1) pika 5 e LRQP.

⁷⁰ Sipas nenit 9 LKK.

⁷¹ Gjykata lokale për kundërvajtje mund të bëjë transferimin e rastit në një gjykatë komunale tjetër ku banon i pandehuri, kjo do të ishte më efektive dhe veprimi i pretenduar mund të paraqes një veprë penale sipas juridiksionit të transferuar. Neni 79 (1), LKK.

⁷² Neni 10 DUDNJ, neni 14 (1) PNDPC dhe neni 6 (1) KEDNJ.

⁷³ *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, aktgjykimi nr. 12945/87, 16 dhjetor 1992, para. 33.

mundësi palës që të parashtrojë ankesë kundër vendimit, si dhe mundësinë për të pasur mundësi që të rishqyrtohet vendimi nga organi i apelit. Kjo mund të bëhet vetëm duke lëshuar një vendim të arsyetueshëm që do të jep mundësi që të vihet në syrin e publikut administrimi i drejtësisë.”⁷⁴

Kështu, aktgjykimi i arsyetueshëm është i rëndësishëm për shkak se i jep mundësi të pandehurit të drejtën për të parashtuar ankesë, dhe kjo ndërlidhet me të drejtën për gjykim publik siç garantohet me instrumentet rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.⁷⁵ Duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, ligji i Kosovës obligon që vendimi me shkrim për procedurën kundërvajtëse duhet të përmbajë “arsyetimet esenciale për situatën e konstatuar faktike, me citim të shkurtë të dëshmive të bazuara mbi të cilat disa fakte konsiderohen se janë të dëshmuara, si dhe përshkrimi mbi të cilin janë bazuar thëniet e vendimit.”⁷⁶

OSBE ka monitoruar raste ku GJK nuk kanë dhënë arsytetime të mjaftueshme në aktgjykimet e tyre në rastet e shkeljes së ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për gjykim të drejt.

Për shembull, me 17 mars 2006, Gjykata për Kundërvajtje në Pejë/Peć kishte lëshuar një vendim kundër një të pandehuri dhe e kishte dënuar atë me gjobë prej 80 euro për shkak se e ka shpallur se ai ka qenë përgjegjës për disa vepra për kundërvajtje në komunikacion.⁷⁷ Megjithatë, duket se gjyqtari e kishte kopjuar aktgjykimin nga një aktgjykim tjetër pasi i referohet fakteve tjera të ndryshme, personi tjetër, dhe ankesat e ndryshme ligjore në krahasim me ato të cilat janë të shënuara në të njëjtin aktgjykim.

Në një rast tjetër, me 28 prill 2006, Gjykata për Kundërvajtje në Prizren e kishte shpallur një person se ishte përgjegjës për shkelje të rregullave të komunikacionit dhe e kishte dënuar atë me gjobë. Arsyetimi i aktgjykimit citon: “pasi që inicimi i procedurës për kundërvajtje ishte parashtuar nga një organ tjetër, dhe raporti është i bazuar nën vrojtimin e drejtpërdrejt të personit të autorizuar, pa dyshim është vërtetuar se i pandehuri ka kryer vepër të kundërvajtjes [...]”

Këto raste paraqesin arsytetime jo të qarta, mungesë të plotë ose arsyetim jo të mirëfilltë të aktgjykimeve. Kjo shkel jo vetëm ligjin vendor por dhe standardet ndërkombëtare për gjykim korrekt lidhur me të drejtën për vendim të arsyetuar, ankesë dhe gjykim publik të parapara me nenin 6 të KEDNj.⁷⁸ Arsyetimi i pamjaftueshëm i vendimit gjithashtu cenon besueshmërinë e gjykatave dhe zbeh besimin e publikut në gjyqësor.

⁷⁴ *Suominen kundër Finlandës*, aktgjykimi nr. 37801/97, 24 korrik 2003, para. 37.

⁷⁵ Neni 14 (5), PNDCP. Shiko gjithashtu edhe nenin 2, Protokollin nr. 7 o Konventës evropiane për të drejtat e njeriut dhe lirive fundamentale, të adoptuar në Strasburg më 22 nëntor 1984.

⁷⁶ Neni 204 (5), LKK.

⁷⁷ Nenet 228 (1), pjesa 21, 230 (1), pjesa 23 dhe 26 të Ligjit mbi bazat e sigurisë në komunikacion rrugor (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, nr. 50/88 dhe 63/88).

⁷⁸ OSBE kishte vërejtur probleme me arsytimet gjyqësore në vendimet e Gjykatave për Kundërvajtje në tërë Kosovën.

C. Mungesa e dënimeve individuale

Gjykatat duhet të sigurojnë që çdo dënim duhet të individualizohet dhe të jepet llogari për çdo rrethanë e veçantë lehtësuese apo rënduese për të pandehurin kur të vendoset për dënime. Shqiptimi i dënimeve individuale për secilin të pandehur i ndihmon gjyqtarët në përpilimin e vendimit të drejtë dhe të arsyetueshëm.⁷⁹

Sipas ligjit vendor, kur të vendoset për dënimin, GJK duhet të merr parasysh “të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e lartë apo të ulët të dënimit, dhe posaçërisht karakterin e peshës së veprës së kryer, rrethanat në të cilat është kryer vepra, shkallën e përgjegjësisë, rrethanat personale të të pandehurit, si dhe sjellja e tij/saj pas kryerjes së veprës.”⁸⁰ Gjithashtu, me ligj kërkohet që të bëhet arsyetimi i detajuar i aktgjykimit, duke përfshirë edhe përshkrimin e fakteve të dëshmuara që plotësojnë kërkesat e elementeve ligjore të veprës.⁸¹

Edhe përkundër këtyre kërkesave, OSBE kishte monitoruar rastet në të cilat gjykatat kishin shqiptuar dënime kolektive dhe kishte dështuar që të shpjegojë nivelin e përgjegjësisë për secilin të pandehur.

Për shembull, me 9 qershor të vitit 2006, SHPK në Prishtinë/Priština kishte parashtruar një kërkesë në Gjykatën për Kundërvajtje për të filluar me procedurën kundërvajtëse⁸² kundër nëntë personave, të gjithë anëtarë të lëvizjes “Vetëvendosja”. Kjo ishte bërë për shkak se të pandehurit kishin bllokuar hyrjen kryesore të ndërtesës së selisë kryesore të KB-ve gjatë një proteste që ishte mbajtur në të njëjtën ditë. Kjo nxirret si shkak se kanë ndaluar lirinë e lëvizjes së punëtorëve të cilët punojnë në atë kompleks. Në fund të gjykimit, gjykata i kishte shpallur të gjithë fajtorë dhe i kishte dënuar me nga 10 ditë burg për secilin. Megjithatë, në shpjegimin-arsyetimin e vendimit, gjykata kishte folur për sjelljet e të pandehurve në mënyrë kolektive, pa ndonjë referencë në veprimet dhe për shkallën e përgjegjësisë të secilit të pandehur.⁸³

Ne tri rastet e ngjashme të dala nga e njëjta protestë e 9 qershorit 2006 para Gjykatës për Kundërvajtje në Prishtinë/Priština, gjykata i kishte dënuar 26 persona tjerë me nga dhjetë ditë burg. Sipas rastit të përshkruar më sipër, gjykata në mënyrë jo të drejtë i kishte dënuar të pandehurit kolektivisht pa e diskutuar përgjegjësinë individuale të secilit.

Në përmbledhje, rastet e monitoruara nga OSBE tregojnë se GJK kanë shqiptuar në mënyrë jo të drejtë dënime kolektive kundër të pandehurve pa bërë dallime në nivelin

⁷⁹ “Gjykatat duhet që të cekin në përgjithësi arsyetimet konkrete për shqiptimin e dënimit. Në veçanti, duhet të jepen arsyetime të veçanta kur të shqiptohen dënime me kusht [...] ajo çka llogaritet si ‘arsye’ është motivimi i cili ndërlidhet me dënimin e veçantë deri te shkalla normale e dënimit për llojin e krimin dhe të shpjegimeve të deklaruara për dënim.” Rekomandimi nr. R (92) 17 i Komitetit të ministrave të shteteve palë të Këshillit të Evropës, *Që ka të bëjë me përputhshmërinë gjatë shqiptimit të*, 19 tetor 1992, Pjesa E.

⁸⁰ Neni 7, LKK.

⁸¹ Nenet 205-206, LKK.

⁸² Sipas nenit 20 (1) pjesa 3 e LRQP.

⁸³ Vendimi citon: “gjyqtari konstaton se të pandehurit e sipërpërmendur kishin kryer vepra të kundërvajtjes [...] kështu, ata janë të dënuar me nga 10 ditë burg për secilin prej tyre”.

e përgjegjësive individuale duke shkelur kështu ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

D. Shkelja e parimit ne bis in idem në lidhje ne aktgjykimet e mëparshme të lëshuara nga Gjykatat për Kundërvajtje.

Për kundërvajtjet (siç janë ato të LRQP si dhe disa prej Ligjit mbi komunikacionin dhe sigurinë në rrugë) të cilat duhet të klasifikohen si penale sipas GjEDNj, gjykatat duhet të respektojnë parimin e *ne bis in idem* sipas konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sipas ligjit kombëtar.

Sipas së drejtës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, që drejtpërdrejt zbatohet në Kosovë, në rastet penale “Askush nuk mund të ndiqet ose të ndëshkohet për një shkelje nga e cila ai është liruar ose dënuar njëherë nga një vendim definitiv në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të çdo vendi.”⁸⁴

I njëjti parim, ku vepra konsiderohet penale sipas praktikës së GjEDNj, gjithashtu është i inkorporuar në Kodin e përgjithshëm të procedurës penale të Kosovës,⁸⁵ kur personi është gjykuar dhe dënuar ose liruar-shfajësuar në rastin para GJK, dhe duhet të respektohet nga gjykatat e Kosovës.

Në disa dispozita, Ligji për kundërvajtje inkorporon aspekte të parimit *ne bis in idem*. Për shembull, ligji citon se “personi i cili në procedurën penale ose në procedurën për kundërvajtje ekonomike është shpallur me vendim të plotfuqishëm fajtor për veprën e cila ka shenja të kundërvajtjes, nuk do të dënohet për kundërvajtje.”⁸⁶ Gjithashtu, nëse gjatë procedurës për kundërvajtje “i pandehuri në procedurën penale shpallet fajtor [...] për të njëjtën vepër që ka karakteristika të kundërvajtjes.

Ngjashëm me këtë, edhe pse nuk është e futur në mënyrë të qartë në ligjin e tanishëm të Kosovës, parimi *ne bis in idem* duhet të ndalojë gjykatat komunale dhe ato të qarkut që të gjykojnë të pandehurit të cilët kanë qenë të gjykuar ose të dënuar ose të shfajësuar për të njëjtat fakte në rastet në para gjykatave për kundërvajtje ku vepra konsiderohet të jetë penale sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj.⁸⁷

Edhe përkundër këtyre kërkesave legjitime sipas ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, OSBE kishte monitoruar rastet ku gjykatat kishin shkelur parimin *ne bis in idem*.

⁸⁴ Neni 14 (7) i Konventës ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike. Shiko gjithashtu edhe nenin 4 (1) Protokollin nr. 7 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut që citon se “Askush nuk mund të ndiqet ose të dënohet penalisht nga juridiksionet e të njëjtit Shtet për një vepër për të cilën ai më parë ka qenë deklaruar i pafajshëm ose dënuar me një vendim gjyqësor përfundimtar në përputhje me ligjin dhe procedurën penale të këtij Shteti.”

⁸⁵ Neni 4 (1), KPPPK citon se “Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për vepër penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës.”

⁸⁶ Neni 14 (2), LKK.

⁸⁷ Shiko *supra* at 88, mbi parimin *ne bis in idem* siç është e shprehur në KPPPK.

Në një rast para Gjykata Komunale të Pejës/Peç, gjykata i kishte gjykuar pesë të pandehur me 13 qershor 2006 për sulm ndaj personave zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare⁸⁸ dhe për pjesëmarrje në grup i cili kishte penguar personat zyrtarë që të kryejnë detyrat e tyre zyrtare.⁸⁹ Vepra ishte kryer nga anëtarët e lëvizjes “Vetëvendosja” në një protestë para stacionit lokal të policisë në fund të gushtit 2005. Të gjithë të pandehurit ishin deklaruar se ishin fajtorë dhe ishin dënuar me nga gjashtë muaj burg me kusht për dy vite. Vlen të përmendet se, me 07 shtator të vitit 2005 Gjykata për Kundërvajtje në Pejë/Peç më parë kishte dënuar të njëjtit persona për faktet që lidhen me të njëjtën protestë të gushtit 2005⁹⁰ me dënim me burg që ndryshonte prej 15 deri 20 ditë.

Në një rast tjetër, e njëjta gjykatë i kishte dënuar dy të pandehur me 15 shtator 2005 për sulm ndaj personave zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.⁹¹ Të pandehurit ishin deklaruar se ishin fajtorë dhe ishin dënuar me nga katër muaj burg me kusht për një vit. Megjithatë, me 19 nëntor 2004, Gjykata për Kundërvajtje e Pejës/Peç i kishte dënuar të njëjtit persona për faktet e njëjta dhe i kishte dënuar ata me gjobë.⁹²

Në shembujt e përshkruar më lartë, këto kundërvajtje ka gjasa të konsiderohen sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së si penale.⁹³ Dhe si pasojë, zbatohet parimi *ne bis in idem*, dhe të pandehurit nuk duhet të akuzohen dhe dënohen dy herë për të njëjtat fakte. Këtu, gjykata për kundërvajtje kishte shkelur parimin duke gjykuar dhe dënuar të pandehurit dy herë për të njëjtat vepra dhe fakte.⁹⁴

III. REKOMANDIMET

Për autoritetet vendore dhe ndërkombëtare si UNMIK-u, Ministria e Drejtësisë, Parlamenti i Kosovës dhe Shërbimi Policor i Kosovës:

- Legjislacioni i tanishëm për kundërvajtjet duhet të ndryshohet në mënyrë që të jetë në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe duhet të përfshijë garancitë për gjykime të drejta për rastet penale ku kundërvajtja kualifikohet si vepër penale sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ;
- Të marrin parasysh ndryshimin e legjislacionit të tanishëm për të larguar burgimin si dënim potencial për individët të cilët shkelin ligjin për kundërvajtje.

⁸⁸ Neni 317(2), KPPK.

⁸⁹ Neni 318, KPPK.

⁹⁰ Sipas nenit 18 (1), pjesa 11 e LRQP.

⁹¹ Neni 317 (1), KPPK.

⁹² I akuzuari kishte parashtruar një ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë/Priştina, që e kishte konfirmuar vendimin e GJK në Pejë/Peç më 4 shkurt 2005.

⁹³ Shiko *Oliveria kundër Zvicrës aktgjykimi nr. 25711/94*, 30 korrik 1998, para. 26.

⁹⁴ Në këtë kontekst, kualifikimi i ndryshëm ligjor i veprës penale nuk duhet të konsiderohet si relevant pasi që të dyja veprat janë bazuar në të njëjtat fakte. Shiko *Gradinger kundër Austrisë*, aktgjykimi nr. 15963/90, 23 tetor 1995, para. 55.

Për policinë dhe autoritetet tjera të autorizuar për inicimin e procedurës kundërvajtëse:

- Të hartohen kërkesat e qarta për fillimin e procedurës në gjykatat për kundërvajtje në atë mënyrë që të përfshijnë të gjitha informatat e kërkuar me ligj, posaçërisht përshkrimin e fakteve dhe kualifikimin ligjor të kundërvajtjes.

Për gjyqtarët në Gjykatat për Kundërvajtje:

- Nëse kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse nuk përmban të gjitha të dhënat e kërkuara, duhet t'i kthehet parashtruesit për t'i korrigjuar mangësitë brenda afatit të caktuar kohor sipas ligjit - jo më shumë se 15 ditë. Kur parashtruesi i kërkesës nuk e bënë korrigjimin brenda afatit të caktuar kohor, kërkesa duhet të refuzohet;
- Të shqiptojnë aktgjykimet e arsyetueshme në mënyrë që të mbrohen të drejtat për ankim dhe për gjykim publik siç kërkohet me ligj vendor dhe me standarde ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Kur t'i gjykojnë rastet me shumë të pandehur që janë gjetur përgjegjës për kundërvajtje, t'i dënojnë të pandehurit individualisht dhe t'iu shpjegojë dënimet secilit sipas nivelit të përgjegjësisë të secilit prej tyre.

Për gjyqtarët dhe prokurorët në Gjykatat e Qarkut dhe ato Komunale:

- Të respektojnë parimin e *ne bis in idem* dhe t'i shmangen ndjekjes penale të individëve të cilët janë liruar nga përgjegjësia apo janë gjetur përgjegjës në procedurën paraprake në gjykatat për kundërvajtëse, kur vepra konsiderohet të jetë e natyrës penale nga praktika gjyqësore e GjEDNj.

Për IGJK:

- Të organizojë trajnime për hartimin e vendimeve gjyqësore që fokusohen në lëshimin e vendimit të arsyetuar mirë si dhe të parimit *ne bis in idem*.

Për Odën e Avokatëve të Kosovës

- Të organizojë trajnime për avokatët mbrojtës në lidhje me klasifikimin e veprës si penale më parë se si disiplinuese apo administrative siç parashihet me KEDNj si dhe për garancitë e kërkuara procedurale në procedurat për kundërvajtje nga praktika gjyqësore e GjEDNj.

KAPITULLI 3

TË MITURIT NË PROCEDURËN PENALE

Standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë, të parapara me PNDCP⁹⁵ dhe KEDNj⁹⁶ aplikohen gjithashtu edhe në procedurën penale kundër të miturve. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve e vitit 1989 (KDF) përmban rregulla⁹⁷ të ngjashme me ato nga KNDCP dhe KEDNj për procedurat ku përfshihen fëmijët e akuzuar për krime.

KDF më tej, si parim të përgjithshëm cekë se “[n]ë të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, pa marrë parasysh a ndërmerren ato nga institucionet shoqërore private apo publike për mirëqenie, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativ, interesat më të mirë të fëmijës do të jenë konsiderata primare”⁹⁸. Komisioni për të Drejtat e Fëmijës theksoi se “[...] çdo organ apo institucion legjislativ, administrativ apo juridik është i obliguar ta zbatoj parimin e interesave më të mirë duke marrë parasysh në mënyrë sistematike se si të drejtat dhe interesat e fëmijës janë apo do të jenë të prekura nga vendimet dhe veprimet e tyre [...]”⁹⁹. Për më tepër, është obligim i autoriteteve publike që në të gjitha rastet të marrin parasysh si dhe të mbrojnë interesat më të mirë të fëmijës.¹⁰⁰

Ky kapitull shkurtimisht përshkruan sistemin e drejtësisë penale për të mitur në Kosovë dhe nënvizon shkeljet e ligjit vendor (Ligji Penal për të Mitur i adoptuar së fundi) dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që ndërlidhen me të miturit në sistemin e drejtësisë penale. OSBE ka vërejtur raste ku përfshiheshin të mitur, të kenë pasur shkelje procedurale, siç janë trupi gjykues i parregullt, vonesa në procedura penale ku përfshiheshin të miturit, periudha paraburgimi të tej-zgjatura dhe joligjore kundër të pandehurve të mitur, dhe procedura joligjore për kundërvajtje kundër të miturve më të rinj se katërmëdhjetë vjeç.

I. KORNIZA LIGJORE

Qëllimi kryesor i sistemit të drejtësisë penale për të mitur bazuar në ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut duhet të jetë rehabilitimi i fëmijës dhe ri-integrimi i tij në shoqëri¹⁰¹. Që të ketë përputhshmëri me standardet ndërkombëtare dhe obligimet në lidhje me drejtësinë për të mitur, autoritetet publike duhet të miratojnë ligje specifike në nivel vendor.¹⁰²

⁹⁵ Nenet 9 dhe 14 të KNDCP.

⁹⁶ Nenet 5 dhe 6 të KEDNj.

⁹⁷ Neni 40, KDF.

⁹⁸ Neni 3 (1), KDF.

⁹⁹ *Komenti Nr 5 (2003) i Komisionit për të Drejtat e Fëmijëve mbi “Masat e përgjithshme për implementimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”* (Dokument i KB-ve CRC/GC/2003/5, 27 Nëntor 2003) paragrafi 12, nenet 4, 42 dhe 44 par.6.

¹⁰⁰ Për një pasqyrë të parimeve të KDF-së, ju lutem shihni “*Manuali mbi implementimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës – edicioni i korrigjuar tërësisht*, (UNICEF, 2002) fq. 784 nga Rachel Hodgekin dhe Peter Newell.

¹⁰¹ Neni 40 (1), KDF.

¹⁰² Neni 40 (3), KDF.

Ligji Penal për të Mitur i Kosovës (LPM) është nxjerrë me 20 prill 2004, përmes Rregullores së UNMIK-ut 2004/8. LPM përmban parime udhëzuese, kërkesa substanciale dhe procedurale mbi drejtësinë për të mitur si dhe dispozita mbi dënimet e përshtatshme për të miturit. Qëllimi kryesor i ligjit të ri është që të sjell sistemin e drejtësisë penale për të mitur në përputhshmëri me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në rastet penale në të cilat të miturit janë të pandehur apo viktime.¹⁰³

LPM duhet të shikohet si *lex specialis* (ligj i veçantë) kur krahasohet me KPPPK dhe ligjet tjera që mund të jenë të zbatueshme për të miturit në procedurat penale.¹⁰⁴ Prandaj, në raste konflikti ndërmjet LPM-së dhe ligjeve tjera, është LPM ai që duhet të dominoj. Megjithatë, LPM duhet të aplikohet duke marrë në konsideratë edhe teknikat tjera relevante të interpretimit (që do të thotë faktet dhe dispozitat penale e paqarta të interpretohen në favor të të pandehurit¹⁰⁵).

OSBE ka monitoruar raste ku autoritetet kanë zbatuar gabimisht dispozitat e LPM-së në shkelje të ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut lidhur me të miturit në procedurat penale. Në disa raste, gjykatat kanë pasur vështirësi të kuptojnë marrëdhëniet ndërmjet LPM dhe KPPK dhe aplikimit të rregullës së duhur.

II. SHKELJET E VËZHGUARA TË LIGJIT VENDOR DHE STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË SË DREJTAVE TË NJERIUT

A. Gjykata jo e themeluar në pajtim me ligj

OSBE ka monitoruar raste që përfshinin të pandehur apo viktime të mitur ku përbërja e trupit gjykues nuk përputhej me ligjin vendor apo standardet ndërkombëtare për gjykim të drejtë.

E drejta për gjykim të drejtë, përmban të drejtën për t'u gjykuar nga gjykata e themeluar me ligj.¹⁰⁶ Në interpretimin e kësaj të drejte, GJEDNJ ka theksuar se gjykata duhet të ketë përbërje të duhur “në përputhje me ligjin” dhe nënvizoi se do shkelja ndodhë në rastet kur gjykata nuk funksionon bazuar në ligjin e aplikueshëm procedural.¹⁰⁷

Rëndësia e parimit për interesin më të mirë për fëmijën, ka rezultuar që Komisioni për të Drejtat e Fëmijëve të vërtetojë se autoritetet “[...] duhen të kushtojnë vëmendje të veçantë që të sigurojnë se procedurat efektive të ndjeshme për fëmijë, të jenë në dispozicion për fëmijët dhe përfaqësuesit e tyre.”¹⁰⁸

Ligji aktual i Kosovës urdhëron që trupi gjykues për të mitur t'i gjykoj rastet kundër të miturve¹⁰⁹ dhe që trupi gjykues për të mitur, apo gjyqtari për të mitur t'i gjykoj të

¹⁰³ Shih p.sh. nenet 1-5 dhe 141-149, LPM.

¹⁰⁴ Neni 4, LPM.

¹⁰⁵ Neni 3 (2) KPPPK.

¹⁰⁶ Neni 14 (1) KNDKP dhe neni 6 (1) KEDNJ.

¹⁰⁷ *Zand v. Italisë*, raporti i komisionit nr. 7360/76, 1978 dhe *Rossi v. Francës*, raporti i komisionit nr. 11879/85, 1989.

¹⁰⁸ Komenti i përgjithshëm nr. 5 (2003) supra at 5, para. 24 i Komisionit për të Drejtat e Fëmijës.

¹⁰⁹ Nenet 2 (10) dhe (11) dhe kapitulli XI, LPM.

rriturit për disa vepra penale të kryera kundër fëmijës.¹¹⁰ Dispozitat tjera të LPM-së kërkojnë që trupi gjykues për të mitur të jetë i përbërë prej gjyqtarëve porotë të gjinive të ndryshme¹¹¹ dhe që gjyqtari për të mitur të vendos lidhur me kërkesat për paraburgim kundër të miturit.¹¹²

Gjyqtari për të mitur sipas LPM-së është definuar si “gjyqtar profesional që ka ekspertizë në çështjet penale ku përfshihen të miturit.¹¹³ Krijimi i trupit gjykues për të mitur, së bashku me rregullat të cilat rregullojnë përbërjen e tij kanë për qëllim të sigurojnë që interesat më të mirë të fëmijës të merren në konsideratë gjatë procedurave penale. Parimi i interesave më të mirë të fëmijës, tashmë përgjithësisht i shprehur nga KDF, është elaboruar më tej sipas Rregullave të Pekinit¹¹⁴ të cilat theksojnë se “[p]rocedurat [penale] do të jenë në favor të interesave më të mirë të së miturit”.¹¹⁵

Dispozitat në LPM lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e gjyqtarit për të mitur dhe trupit gjykues për të mitur kanë për qëllim t’i ofrojnë të pandehurve ose viktimave të mitur në veprat e rënda penale, mbrojtje të veçantë përbrenda sistemit të drejtësisë penale, siç kërkohet me standardet e aplikueshme ndërkombëtare.

Përkundër këtyre dispozitave të ligjit vendor dhe standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, OSBE ka vërejtur shkelje të rregullave lidhur me përbërjen e trupit gjykues për të mitur.

Për shembull, në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica me 18 Maj 2006, një trup i zakonshëm gjykues kryesoi një gjykim ku përfshihej një i akuzuar i ngarkuar me veprën penale të keqtrajtimit seksual¹¹⁶ të kryer kundër një vajze 12 vjeçare përkundër asaj që LPM urdhëron që gjyqtari apo trupi gjykues për të mitur të merret me rastin.¹¹⁷

Në rastin e dytë para Gjykatës së Qarkut në Gjilan/Gnjilane kundër të pandehurit të akuzuar për krimin e keqtrajtimit seksual të personit nën moshën 16 vjeç,¹¹⁸ trupi i zakonshëm gjykues kryesoi gjykimin e mbajtur me 15 Gusht 2005. Edhe pse gjykata e dënoi të pandehurin, Gjykata Supreme e ndryshoi

¹¹⁰ Neni 141 LPM numëron veprat penale.

¹¹¹ Neni 49 (4) LPM. Neni 147, LPM zbaton këtë rregull në lidhje me trupat gjykues për të mitur në rastet penale ku përfshihen viktimat fëmijë të paraparë me nenin 141.

¹¹² Neni 64 (1), LPM.

¹¹³ Neni 2 (10), LPM.

¹¹⁴ Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (“Rregullat e Pekinit”), të adoptuara nga Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve Nr. 40/33 e 29 Nëntorit 1985.

¹¹⁵ Rregullat e Pekinit, rregulla 14.2. Komenti mbi rregullën e njëjtë thotë se me “autoritet kompetent nënkuptohet përfshirja e atyre të cilët kryesojnë nëpër gjykata (të përbërë nga gjyqtari i vetëm apo nga disa anëtar), duke përfshirë këtu gjyqtarë profesional apo porotë [...]. Në procedura kur veprohet me shkelës të mitur do të zbatohen në të gjitha rastet standardet minimale të cilat aplikohen pothuajse gjithandej për secilin të pandehur penal nën procedurën e njohur si “proces i duhur i ligjit”. Në përputhje me procesin e duhur, një ‘gjykim i drejtë dhe korrekt’ përmban garanci aq themelore siç janë supozimi i pafajësisë, prezantimi dhe dëgjimi i dëshmitarëve, mbrojtjet ligjore të zakonshme, e drejta e heshtjes, e drejta e fjalës së fundit në seancë, e drejta për ankesë, etj”

¹¹⁶ Neni 195 (4), KPPK.

¹¹⁷ Neni 141 (93), LPM.

¹¹⁸ Neni 198 (1), KPPK.

aktgjykimin dhe e kthej lëndën në rishqyrtim¹¹⁹ për shkak të përbërjes së gabuar të trupit gjykues. Përkundër kësaj, trupi gjykues i zakonshëm (që nuk ishte në pajtim me kërkesat e LPM) prapë gjykoi rastin me 6 Prill 2006.

Në një tjetër rast para Gjykatës Komonale në Pejë/Peć, me 13 Prill 2006 dy gjyqtarë porotë të gjinisë së njëjtë kryesuan në një gjykim kundër dy të miturve të cilët kishin kryer veprat penale; lëndime të lehta trupore,¹²⁰ vjedhje e rëndë,¹²¹ dhe vjedhje.¹²² Fakti se gjyqtarët porotë nuk ishin të gjinive të ndryshme ka shkelur kërkesat e LPM-së.

OSBE gjithashtu ka vëzhguar një rast në të cilin paraburgimi i fëmijës nuk ishte urdhëruar nga gjyqtari për të mitur, siç kërkohet nga LPM.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Priština, prokurori hetoi një të mitur femër të dyshuar për tentim vrasje të një mashkulli, i cili më parë dyshohej se e kishte dhunuar atë.¹²³ Me 9 dhjetor 2004, në shkelje të nenit 64 (1) të LPM, gjyqtari i procedurës paraprake – i cili nuk ishte gjyqtar për të mitur- urdhëroi paraburgimin për një muaj.

Shembujt e sipërpërmendur tregojnë shkelje të ligjit procedural vendor lidhur me kompetencat dhe përbërjen e trupit gjykues dhe gjyqtarit për të mitur. Për më tepër, këto raste shkelin standardet ligjore ndërkombëtare lidhur me të drejtat për gjykatë dhe gjykim korrekt të themeluar me ligj. Përfundimisht, gjykatat kanë dështuar të mbrojnë parimin e interesave më të mirë të fëmijëve në shkelje të KDF.

B. Vonesat në procedurat penale kundër të miturve

Standardet ndërkombëtare për gjykim korrekt garantojnë se çdokush që është i ngarkuar me vepër penale ka të drejtën e dëgjimit përbrenda kohës së arsyeshme.¹²⁴ GJEDNJ ka deklaruar se qëllimi i kësaj garancie është të mbroj “të gjitha palët në procedurat gjyqësore [...] kundër vonesave të tepërta procedurale”¹²⁵ dhe, në rastet penale, veçanërisht “ka për qëllim t’i shmanget asaj që një person i akuzuar të qëndroj për kohë shumë të gjatë në gjendje të paqartësisë rreth fatit të tij/saj.”¹²⁶ Nën praktikën gjyqësore të themeluar nga GJEDNJ, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës varet nga rrethanat e veçanta të rastit dhe si rrjedhojë nuk ekziston ndonjë kufi absolut kohor.¹²⁷

¹¹⁹ Shih nenet 403 (1) pika 1, 415 (1) pika 1, dhe 424 KPPPK.

¹²⁰ Neni 153 (2), KPPK.

¹²¹ Neni 253 (1) pika 1, KPPK.

¹²² Neni 252 (1), KPPK.

¹²³ KPPK, nenet 146 dhe 20.

¹²⁴ Neni 6 (1) KEDNJ. Shih gjithashtu neni 14 (1), KNDCP.

¹²⁵ Aktgjykimi i *Stögmüller v. Austria*, 1602/62 i datës 10 Nëntor 1969, par. 5 (Seksioni “Sipas ligjit”).

¹²⁶ *Id.*

¹²⁷ Aktgjykimi i *König v. FRG*, 6232/73 i datës 28 qershor 1978, par. 99. GJEDNJ merr parasysh faktorët siç janë ndërlikueshmëria e rastit, sjellja e aplikuesit dhe e autoriteteve gjyqësore dhe administrative të Shtetit, dhe atë se çfarë është në dëm për aplikuesin. Shih, p.sh. *König v. FRG, id.*, dhe aktgjykimi *Buchholz v. FRG*, 7759/77 i datës 6 Maj 1991, par. 49.

Përderisa ligji vendor shpesh përcakton afate kohore për procedurat gjyqësore, shkelja e kërkesave procedurale vendore nuk është e thënë të rezultojë në shkeljen e paraparë sipas nenit 6 (1) të KEDNJ.¹²⁸

Në kundërshtim me këtë, standardi ndërkombëtar mbi të drejtën e gjykimit brenda kohës së arsyeshme është më i ngurtë kur kemi të bëjmë me fëmijë. KDF thotë se në të gjitha veprimet e ndërmarra nga gjykatat lidhur me fëmijët, “interesat më të mirë të fëmijëve do të jenë konsiderata primare”.¹²⁹ Më veçanërisht, bazuar në KDF çdo fëmijë fajtor për vepër penale të pandehur ka të drejtën “e vendosjes së çështjes pa vonesa nga autoriteti kompetent, i pavarur dhe i paanshëm apo organi gjyqësor në një gjykim të drejtë bazuar në ligj.”¹³⁰ Për më shumë, Rregullat e Pekinit¹³¹ theksojnë se “secili rast [kundër të miturit] qysh nga fillimi do të trajtohet shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme.”¹³²

Rregullat dhe parimet e përshkruara më lartë tregojnë se “[v]eprimi i shpejtë në procedurat formale në rastet ku përfshihen të miturit paraqet interes të rëndësishëm të veçantë. Me kalimin e kohës, i mituri do ta ketë tepër të vështirë, nëse jo të pamundur, si nga ana intelektuale ashtu edhe nga ajo psikologjike që të ndërlihd procedurën dhe dispozitën me veprën.”¹³³ Kështu, interesat më të mirë të fëmijëve kërkojnë që gjykatat t’i përmbahen këtyre obligimeve dhe t’u shmangen vonesave të panevojshme në procedurat penale ku përfshihen të miturit.

Sa i përket ligjit vendor, LPM përgjithësisht kërkon që “autoritetet ose institucionet të cilat marrin pjesë në procedurat ku përfshihen të miturit [...] janë të obliguar të veprojnë shpejtë dhe pa vonesa të panevojshme.”¹³⁴ Më veçanërisht, LPM ka vendosur kufizime të rrepta kohore për atë kur trupi gjykues për të mitur pranon ndonjë parashtrësë nga prokurori pasi që të ketë përfunduar procedurën paraprake,¹³⁵ “[n]ë qoftë se gjykatësi për të mitur nuk sjell ndonjë vendim që ta anuloi parashtrësën apo të transferoj çështjen në ndonjë gjykatë tjetër, ai ose ajo do të caktoj shqyrtimin kryesor brenda tetë ditëve nga marrja e parashtrësës.”¹³⁶ Afati i shkurtë kohor për caktimin e shqyrtimit kryesor pas parashtrësës së prokurorit zvogëlon paqartësitë ligjore dhe traumat psikologjike për të miturit në rastet penale. Kjo favorizon interesat më të mirë të fëmijëve.

Përkundër këtyre kërkesave ligjore vendore si dhe standardeve dhe parimeve ndërkombëtare lidhur me drejtësinë për të mitur, OSBE ka monitoruar raste në të cilat gjykatat nuk e kanë përfillur afatin kohor për caktimin e shqyrtimit kryesor:

¹²⁸ GJEDNJ në mënyrë të pavarur do të analizoj çdo rast. Megjithatë, fakti se afatet kohore nga ligji vendor kanë qenë të mos-përfillura mund të tregoj se kohëzgjatja e procedurës ka qenë e paarsyeshme. Për shembull, aktgjykimi B. V. Austria, 11968/86 e datës 28 Mars 1990, Kodi Austriak i Procedurës Penale ka parashikuar që aktgjykimi duhet të silltet brenda katërmëdhjetë ditëve. Megjithëkëtë, gjyqtarit ju deshën tridhjetë e tre muaj që ta kryej këtë detyrë dhe GJEDNJ gjeti se ka pasur shkelje të së drejtës brenda kohës së arsyeshme sipas nenit 6 (1) të KEDNJ. Id, par.54-55.

¹²⁹ Neni 3 (1), KDF.

¹³⁰ Neni 40 92) (b) (iii), KDF.

¹³¹ *Supra* at 117

¹³² Id., Rregulla 20.1. Shih gjithashtu rregullat 7.1, 14.1 dhe 14.2

¹³³ Id., Komenti mbi rregullën 20.1.

¹³⁴ Neni 37 (1), LPM.

¹³⁵ Neni 61 (1), LPM.

¹³⁶ Neni 67 (1) dhe (2), LPM.

Në një rast para Gjykatës Komunale në Pejë/Pec, me 17 mars 2006, prokurori kishte parashtruar kërkesë për caktimin e masës edukative¹³⁷ kundër dy të miturve të cilët kinse kishin kryer veprat penale lëndime të lehta trupore,¹³⁸ vjedhje e rëndë,¹³⁹ dhe vjedhje. Derisa shqyrtimi kryesor është dashur të caktohej brenda 8 ditëve nga marrja e parashtrësës, ai nuk filloi deri me 13 prill 2006.

Në rastin e dytë, me 14 mars 2005, prokurori publik në Gjykatën e Qarkut Mitrovicë/Mitrovica kishte parashtruar një kërkesë për dënimin e një femre të mitur e akuzuar për vrasje në tentativë¹⁴⁰ të kryer kundër një personi i cili kinse e kishte dhunuar atë. Megjithatë, shqyrtimi kryesor filloi me 8 maj 2006, më shumë se 13 muaj pas parashtrimit të kërkesës nga prokurori.

Në përmbledhje, rastet e sipër-përshkruara tregojnë se gjykatat në Kosovë kanë shkelur ligjin vendor, standardet ndërkombëtare për gjykim korrekt, dhe mbrojtjet e veçanta për fëmijët të parapara me KDF duke mos respektuar afatet e caktuara kohore për caktimin e gjytimeve në rastet penale ku përfshihen të miturit.

C. Kohëzgjatja e paraburgimit

Privimi nga liria për fëmijën paraqet një problem të veçantë në atë se fëmija, i cili është ende në fazë të hershme të zhvillimit, mund të pësoj efekte psikologjike serioze madje edhe të pakthyeshme në qoftë se tërhiqet nga familja e tij/saj për qëllime paraburgimi.

Rrjedhimisht, ligji ndërkombëtar për të drejtat e njeriut kërkon që të kufizoj situatat ku fëmijët paraburgosen apo ndalohen në mënyra tjera.¹⁴¹

KDF thotë se “Asnjë fëmijë nuk do të privohet nga liria e tij/saj në mënyrë joligjore ose arbitrare. Arresti, paraburgimi ose burgimi i fëmijës do të jetë në përputhshmëri me ligjin dhe do të përdoret vetëm si masë e mjetit të fundit dhe për periudhën më të shkurtë të përshtatshme kohore.”¹⁴² E inspiruar nga KDF, LPM i Kosovës thotë “Privimi nga liria do të jetë vetëm si mjet i fundit dhe do të jetë e kufizuar në periudhën kohore më të shkurtë të mundshme.”¹⁴³ Më tutje thotë se “[s]i përjashtim, gjykatësi për të mitur mund të urdhëroj paraburgimin nëse [baza specifike nga KPPPK] janë të pranishme dhe në qoftë se alternativat ndaj paraburgimit do të jenë të

¹³⁷ Nenet 6 dhe 16-26, LPM.

¹³⁸ Neni 153 (2), KPPK.

¹³⁹ Neni 253 (1) pika 1 dhe Neni 252 (1) KPPK.

¹⁴⁰ Nenet 146 dhe 20 (1), KPPK.

¹⁴¹ Në përgjithësi, paraburgimi i referohet burgimit para, gjatë dhe pas ndonjë gjykimi penal Nën KPPPK (Nenet 279-297), “paraburgimi” i referohet burgimit para shpalljes së aktgjykimit final në ndonjë lëndë.

¹⁴² Neni 37 (b), KDF. Shih gjithashtu edhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara mbi Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria e tyre, e adoptuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të KB-ve, Nr. 45/113 e datës 14 Dhjetor 1990 e cila nënvizon parimet të cilat do të duhej të respektoheshin nga autoritetet në rastet e të miturve në paraburgim.

¹⁴³ Neni 1 (3), LPM.

pamjaftueshme të sigurojnë praninë e të miturit, të parandalojnë përsëritjen e veprës dhe të sigurojnë mbarëvajtje të procedurës.”¹⁴⁴

Lidhur me periudhat e veçanta kohore të paraburgimit, LPM parasheh që “[i] mituri mund të mbahet në paraburgim në bazë të urdhëresës fillestare për maksimum një muaj nga dita e arrestit të tij/saj. Paraburgimi i të miturit mund të shtyhet vetëm nga trupi gjykues për të mitur nga gjykata kompetente për periudhë shtesë deri në dy muaj.”¹⁴⁵ Kështu, një i mitur mund të mbahet në paraburgim për jo më shumë se tre muaj në përgjithësi pa marrë parasysh fazën e procedurës. LPM gjithashtu thotë se “nenet 279-297 të Kodit të përkohshëm të procedurës penale do të zbatohen *mutatis mutandis* në paraburgimet e të miturve.”¹⁴⁶

Paqartësia rreth nenit 66 (1) LPM dhe referimi i tij në nenet 279-297 të KPPK ka rezultuar në atë që gjyqtarët dhe prokurorët të bien në përfundim të gabueshëm që LPM lejon paraburgimin e të miturve për më shumë se tre muaj. Megjithatë, LPM duhet të interpretohet si *lex specialis* në lidhje me KPPK dhe dispozitat më specifike të LPM e tejkalojnë KPPK-në.¹⁴⁷

Për më tepër, parimet e interesave më të mirë për fëmijën dhe *favor rei*¹⁴⁸ (interpretimi më i favorshëm ligjor për të pandehurin) sugjerojnë që çfarëdo paqartësie lidhur me kohëzgjatjen e paraburgimit duhet të interpretohet në favor të pandehurit të mitur. Rrjedhimisht, të pandehurit të mitur nuk mund t’i caktohet paraburgim për më shumë se tre muaj, bazuar në LPM, standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut si dhe në parimin e përgjithshëm të interpretimit ligjor.

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka monitoruar raste në të cilat gjykatat kanë urdhëruar paraburgimin për më gjatë se tre muaj.

Në një rast para Gjykatës së Qarkut në Prishtinë/Pristina, me 28 nëntor 2005, gjyqtari urdhëroi paraburgimin e një djali pesëmbëdhjetë vjeçar i dyshuar të ketë kryer veprat penale vrasje¹⁴⁹ dhe mbajtje, posedim ose shfrytëzim i paautorizuar i armëve.¹⁵⁰ Me 24 tetor 2006 (pas qëndrimit të paligjshëm në paraburgim për gati një vit), gjykata zgjati paraburgimin edhe për dy muaj shtesë deri me 24 dhjetor 2006.

Në një rast tjetër para gjykatës së njëjtë, i pandehuri i mitur ishte akuzuar për veprën penale të keqtrajtimit seksual të personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, kinse ka kryer akte seksuale kundër një fëmija nëntë vjeçar.¹⁵¹ Me 20 maj 2006, gjyqtari i procedurës paraprake urdhëroi paraburgimin e të pandehurit që vazhdoi deri me 20 shtator 2006 (në përgjithësi katër muaj paraburgim). Në atë datë, gjykata e shpalli atë fajtor dhe e dënoi me një vit e gjashtë muaj burg (ku do të përfshihet koha e kaluar në paraburgim).

¹⁴⁴ Neni 64 (1), LPM.

¹⁴⁵ Neni 64 (2), LPM.

¹⁴⁶ Neni 66 (1), LPM.

¹⁴⁷ Shih nenin 4, LPM.

¹⁴⁸ Shih nenin 3 (2), LPM.

¹⁴⁹ Neni 146, KPPK.

¹⁵⁰ Neni 328 (2), KPPK.

¹⁵¹ Neni 198 (1), KPPK.

Në rastet e sipër-përshkruara OSBE ka vërejtur se avokati mbrojtës nuk ka parashtruar kërkesën *habeas corpus* e cila është në dispozicion nga KPPPK në mënyrë që të sfidojë ligjshmërinë e paraburgimit. Avokatët po ashtu nuk u ankuan për shkeljet procedurale.¹⁵² Më përgjithësisht, OSBE ka vërejtur se avokatët mbrojtës dhe prokurorët shpesh nuk i kundërshtojnë gjyqtarët në rastet kur ka shkelje të ligjit vendor apo standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Avokatët mbrojtës dhe prokurorët mund të ndihmojnë të përmirësohet zbatimi i ligjit dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duke ngritur njohurinë e tyre mbi ligjin vendor si dhe mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, dhe në mënyrë më aktive të kundërshtojnë shkeljet e vërejtura.

D. *Procedurat e kundërligjshme ndaj të miturve në Gjykatat për Kundërvajtje*

Sipas ligjit të aplikueshëm, të miturit mund të ballafaqohen me procedura penale në gjykata komunale, gjykata të qarkut dhe gjykata për kundërvajtje. Siç është diskutuar në kapitullin e dytë i cili fokusohet në gjykatat për kundërvajtje, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ, shumë nga kundërvajtjet mund të klasifikohen si penale dhe të pandehurit kanë të drejtë të gëzojnë standardet ndërkombëtare për gjykim korrekt të kërkuara për procedurat penale.

E një rëndësie të veçantë për të pandehurit e mitur penal, KDF thotë se “minimumi i moshës nën të cilën fëmijët do të konsiderohen se nuk kanë kapacitet për të shkelur ligjin”¹⁵³, duhet të parashihet me ligj. Legjislacioni vendor mbi kundërvajtjet thotë se “[n]jë i mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës nuk ka mbushur katërmëdhjetë vjet (fëmija) nuk do të mbahet përgjegjës për veprën”.¹⁵⁴ Për më shumë, KDF njeh gjithashtu edhe parimin *nullum crimen sine lege*. Sipas këtij parimi, “asnjë fëmijë nuk do të pandehet, akuzohet apo njihet se ka shkelur ligjin penal për shkak të akteve apo lëshimeve të cilat nuk ishin të ndaluara nga ligji vendor dhe ndërkombëtar në kohën e kryerjes.”¹⁵⁵

Ligji vendor dhe parimi i interesave më të mirë për fëmijën kërkojnë që i mituri nën moshën katërmëdhjetë vjeçare në kohën e kryerjes së pandehur të veprës penale nuk do të nënshtrohet procedurave pranë gjykatës për kundërvajtje. Të miturit nën 14 vjeç nuk duhet të nënshtrohen traumave emocionale dhe mentale të procedurave gjyqësore. Për më tepër, të miturit nuk duhet të nënshtrohen procedurave penale për rastet kur ligji i shkelur është zëvendësuar.

Përkundër këtyre kërkesave ligjore, OSBE ka monitoruar rastet ku përfshiheshin të pandehurit e mitur në gjykatat për kundërvajtje për veprat e pandehura të kryera kur

¹⁵² “[N]ë çfarëdo kohe, i paraburgosuri ose avokati i tij/saj mbrojtës mund të kërkojnë nga secili gjyqtar i procedurës paraprake apo kryetar të trupit gjykues të përcaktojë ligjshmërinë e paraburgimit.” Neni 286 (2), KPPPK.

¹⁵³ Neni 40(3)(a), KDF.

¹⁵⁴ Neni 19(1), Ligji mbi Kundërvajtjet të Republikës Socialiste të Serbisë (Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Serbisë, nr. 6/79).

¹⁵⁵ Neni 40(2)(a), KDF.

ata ishin nën moshën 14 vjeçare apo të cilat ishin të bazuara në ligje që nuk janë më të zbatueshme.

Për shembull, me 19 qershor 2006, Gjykata për Kundërvajtje në Prizren gjykoi një të pandehur të mitur për një vepër të dënueshme me burgim deri në dy muaj¹⁵⁶, të cilën e kishte kryer me 30 nëntor 2005 kur ai kishte 13 vjet.¹⁵⁷

Në një rast tjetër pranë gjykatës së njëjtë në datë të njëjtë, gjykata gjykoi një të pandehur të mitur për kundërvajtjen të cilën ai kinse e kishte kryer me 20 shtator 2005, kur ai ishte më i ri se katërbëdhjetë vjet.¹⁵⁸ Një shqetësim tjetër, kërkesa për inicimin e procedurës për kundërvajtje i referohej një ligji i cili ishte shfuqizuar në vitin 2003.¹⁵⁹

Rastet e përshkruara më lartë ilustrojnë se si gjykatat për kundërvajtje kanë shkelur ligjin vendor dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (veçanërisht parimin e “interesave më të mirë për fëmijët” paraparë nën KDF) duke i gjykuar të miturit për veprat e pandehura penale të cilat ata i kishin kryer kur ishin nën moshën 14 vjeçare apo sipas ligjeve të cilat nuk janë më të zbatueshme në Kosovë.

III. REKOMANDIMET

Për gjyqtarë, prokurorë dhe autoritete tjera relevante:

- T’i përmbahen parimit “të interesave më të mirë për fëmijët” në procedurat penale ku përfshihen të miturit;
- Të sigurojnë që paraburgimi i shqiptuar kundër të miturve të mos tejkaloj tre muaj; dhe,
- Të lirohen të gjithë të miturit të mbajtur në paraburgim për më tepër se tre muaj në kundërshtim me ligjin ekzistues dhe standardeve ligjore ndërkombëtare (siç është KDF).

Për gjyqtarë:

- T’i përmbahen në mënyrë rigorozë rregullave procedurale të dhëna në LPM përkitazi me rolin e gjykatësit për të mitur dhe përbërjes së trupit gjykues në procedurat penale ku përfshihen të miturit;
- Siç kërkohet me ligj, gjykatësit porotë duhet të jenë të gjinive të ndryshme;

¹⁵⁶ Neni 18 (1) pika 5, Ligji mbi Qetësinë dhe Rendin Publik (Gazeta Zyrtare e Kosovës, nr. 13/81).

¹⁵⁷ I pandehuri ishte lindur më 4 prill 1992.

¹⁵⁸ I pandehuri ishte lindur më 8 korrik 1992.

¹⁵⁹ Kërkesa për fillimin e procedurës kundërvajtëse i referohet nenit 111 (1) pika 24 e Ligjit mbi Pyjet të vitit 1987 (Gazeta Zyrtare e KSA të Kosovës, Nr. 10/87). Megjithatë, neni 39 i Ligjit nr. 2003/3 Mbi Pyjet në Kosovë, e shpallur nga Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2003/6 (20 mars 2003) e shfuqizoi Ligjin mbi Pyjet të vitit 1987.

- Trupi gjykues për të mitur dhe gjykatësi për të mitur duhet t'i gjykojë të rriturit të cilët pandehen të kenë kryer veprat penale kundër fëmijëve të parapara me nenin 141 të LPM;
- Të veprojnë në mënyrë ekspeditive dhe t'u shmangen çfarëdo vonesave të panevojshme në procedurat penale ku përfshihen të miturit; dhe,
- Sapo që trupi gjykues për të mitur ta pranojë propozimin nga prokurori publik për shqiptimin e ndonjë mase edukative apo dënimi në fund të procedurës përgatitore, përveç nëse ekziston një vendim për hedhjen poshtë të propozimit apo për transferimin e çështjes te ndonjë gjykatë tjetër, gjykatësi për të mitur duhet menjëherë, dhe jo më vonë se tetë ditë, të caktoj shqyrtimin kryesor.

Për avokatët që përfaqësojnë të pandehurit të mitur:

- Të parashtrajnë kërkesën *habeas corpus* për lirim të të miturve të cilët janë aktualisht në paraburgim për një periudhë më të gjatë se tre muaj.¹⁶⁰

Për të gjitha Gjykatat për Kundërvajtje:

- Gjykatat për kundërvajtje nuk duhet të gjykojnë të miturit për veprat e pandehura të kryera nën moshën katërmëdhjetë vjeçare dhe/ose bazuar në ligje të cilat nuk janë më të zbatueshme.

Për Odën e Avokatëve të Kosovës:

- Të organizojë trajnime për avokatët mbrojtës mbi LPM-në, lidhshmërinë e tij me KPPK-në dhe mbi standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me drejtësinë për të mitur.

¹⁶⁰ Neni 286 (2), KPPK.